

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6150
E mërkurë, 28 tetor 2020
çmimi 0.40 €

Të enjten takimi
i radhës në mes të
Kosovës dhe Serbisë në
nivel ekspertësh FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

TRE TË VDEKUR DHE 197 RASTE TË REJA ME COVID NË KOSOVË
GJATË 24 ORËVE TË FUNDIT FAQE 4-5

PARALAJMËROHEN MASA TË REJA KUNDËR COVIDIT NË KOSOVË



Rritja e numrit të të infektuarve me Covid-19 në javët e fundit ka shtyrë institucionet e vendit të mendojnë për masa të reja për parandalimin e përhapjes së Covid-19. Ministri i

Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka bërë me dije se shumë shpejt qeveria do të dalë me vendime për masa të reja për Kosovën në përgjithësi dhe për Prishtinën në veçanti, e cila është bërë

epiqendër e infeksionit. Në 24 orët e fundit kanë vdekur tre pacientë, ndërkaq janë konfirmuar edhe 197 raste të reja me Covid, 92 prej tyre vetëm në Prishtinë

GJERMANIA DHURON 15 VETURA TË REJA PËR POLICINË E KOSOVËS



Policia Federale e Gjermanisë të martën, në një ceremoni të organizuar në ambientet e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Kosovës, ka bërë dhurimin e një donacioni të rëndësishëm prej 15 veturave për Policinë Kufitare të PK-së. Pesëmbëdhjetë automjetet që erdhën si dhuratë janë të modelit "Duster" nga prodhuesi "Dacia", veturë kjo e cila dallohet për multi-funksionalitetin teknologjik dhe për qasjen e mirë në terrene të ndryshme pavarësisht prej vështirësisë FAQE 7

Ngrihet aktakuzë kundër 29 personave për pastrim të parave dhe për bixhoz të paligjshëm

OPINION

STANDARDET E DYFISHTA TË GJYKATËS SPECIALE TË "KOSOVËS" NË HAGË! F. 11

Nga KMDLNj



AKTUALE



LËVIZJA FOL: KOMUNAT NUK TREGUAN TRANSPARENCË NË PLANET E TYRE TË VEPRIMIT F. 6

AGK-ja PUBLIKON HULUMTIMIN 'NDIKIMI I PANDEMISË COVID-19 NË GJENDJEN EKONOMIKE TË GAZETARËVE' F. 6

EKONOMI



REÇICA NË TIRANË: REGJIONI TË PUNOJË MË SHUMË PËR INTEGRIMIN E KOMUNITETEVE PAKICË F. 9

NJË MUAJ PARABURGIM PËR PRONARIN E KOMPANISË KU U TRANSFERUAN MBI 2 MILIONË EURO F. 8

SPORT

FERONIKELI RIKTHEN KRIZËN E LLAPIT F. 16

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Evropa në prag të izolimit nga Covid-19

BERLIN, 27 TETOR - "Jemi para muajve shumë të vështirë. Kështu nuk do të mund të vazhdojmë", ka paralajmëruar kancelarja gjermane Angela Merkel gjatë një takimi me anëtarët e tjerë të partisë së saj. Në Francë, Itali, Holandë, Çeki, Austri, Slloveni, Belgjikë dhe Spanjë, për vetëm dhjetë ditë numri i të infektuarve me Covid-19 është dyfishuar, duke paralajmëruar masa të ashpëruara dhe në ato vende që tashmë janë në izolim. Franca paralajmëron se numri i rasteve të reja me Covid-19 mund të shkojë deri në 100 mijë. E rekordi i mëparshëm ka qenë 52 010 raste të reja me Covid-19

brenda 24 orëve. Izolimin klasik tashmë po e aplikojnë Belgjika, Irlanda, Uelsi. Gjendja e jashtëzakonshme, mes të tjerash, po aplikohet në Spanjë dhe Francë, kurse kancelari austriak Sebastian Kurz ka paralajmëruar se nuk është hedhur poshtë ideja e izolimit. Sipas tij, për këtë do të vendoset bazuar në numrat e rasteve nëpër spitale. E vendi me numrin më të madh të të infektuarve për kokë banori është Çekia. Kryeministri Andrey Babish ka paralajmëruar zgjatjen e gjendjes së jashtëzakonshme. "Nëse nuk ndodh mrekullia, asgjë tjetër nuk do të na mbetet përpos forcimit të masave



mbrojtëse", ka shtuar ai. Tashmë janë mbyllur shkollat dhe shumica e dyqaneve,

ndërkohë shumë çekë nuk po i respektojnë masat. Sllovenia ka njoftuar se nga kjo javë

nuk do të mund të largohen nga vendi ku jetojnë përveç nëse kanë ndonjë urgjencë.

Konfiskohen 352 makina të vjedhura në 22 shtete të Evropës

BRUKSEL, 27 TETOR - 352 makina të vjedhura janë konfiskuar teksa kanë qenë në rrugë për destinacionin e tyre final, si rezultat i një operacioni të mbështetur nga Agjencia e Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit (EUROPOL). Në kuadër të këtij operacioni janë konfiskuar edhe 1 077 pjesë të vjedhura të makinave bashkë me dhjetëra dokumente të falsifikuara.

Në periudhën 12-24 tetor të këtij viti është thënë se janë kryer rreth 44 548 kontrolle të bazave të ndryshme të të dhënave. Operacioni i kërkimit, që është udhëhequr nga



Agjencia Evropiane për Kufij (FRONTEX), është fokusuar në kontrollet nëpër pikëkalime kufitare dhe aktivitete të tjera tokësore në 17 vende të Bashkimit Evropian dhe pesë

shtete të rajonit të Ballkanit. Vendet e përfshira në këtë operacion ka qenë: Kosova, Shqipëria, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Bosnje-Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Estonia,

Franca, Gjermania, Greqia, Hungaria, Italia, Letonia, Lituania, Holanda, Polonia, Portugalia, Rumania, Sllovakia dhe Spanja. "Në bashkëpunim të ngushtë me industrinë private, përfshirë industrinë e makinave, prodhuesit e anijeve dhe kompanitë që japin makina me qira, bashkë me të dhënat e EUROPOL-it, zyrtarët për kontrolle kufitare në kufijtë e jashtëm të BE-së kanë parandaluar kontrabandimin e shumë makinave dhe anijeve më tej kufirit", është thënë në një komunikatë për media të EUROPOL-it.

Aty është thënë edhe se

aktivitetet e fokusuar në kontrollet e veturave dhe të anijeve kanë rezultuar edhe në kapjen e 2 965 migrantëve ilegalë në rrugë drejt BE-së përmes rrugëve tokësore dhe ajrore. Si pasojë, 17 persona që kanë shërbyer si ndërmjetësues të kontrabandimit të migrantëve janë lokalizuar dhe janë arrestuar. "Destinacioni i fundit i migrantëve ka qenë Gjermania apo Italia. Ndërmjetësuesit kanë transportuar migrantët përmes rrugëve tokësore, mirëpo edhe përmes anijeve të vogla në Detin Adriatik", është thënë në njoftim.

Turqia arreston disa pjesëtarë të dyshuar të IS-it

ANKARA, 27 TETOR - Policia turke ka arrestuar të martën shtatë pjesëtarë të dyshuar të grupit ekstremist, Shteti Islamik (IS). Arrestimet ndodhën në Ankara. Ata akuzohen për përgatitjen e sulmeve gjatë festave kombëtare në Turqi, njoftuan mediat dhe zyrtarët. Sipas informacioneve, ata po

planifikonin sulme në Ditën e Republikës që shënohet të enjten dhe ceremonitë që mbahen më 10 nëntor në të cilat përkujtohet themeluesi i shtetit modern turk, Mustafa Kemal Atatürk, njoftoi transmetuesi NTV. Forcat speciale të policisë bastisën shtëpitë e të dyshuarve, dy prej të cilëve besohet se kishin

luajtur një "rol aktiv" në luftimet në Siri. Zyra e kryeprokurorit publik të Ankarasë tha në një deklaratë se shtatë urdhra arrestimi për anëtarët e IS-it u lëshuan të martën dhe ata u arrestuan të gjithë si pjesë e dy hetimeve të ndara, por nuk dha më shumë hollësi. Kombësitë e tyre nuk u bënë



U shpëtuan nga kampi në Siri, kthehen në Shqipëri

TIRANË, 27 TETOR - Amar Rasha, Emel Rasha, Hatixhe Rasha nëna e tyre Floresha Rasha dhe Endri Dumani kanë prekur të martën

tokën shqiptare pas shumë vitesh në Siri. Pranë aeroportit të Rinasit kanë qenë të pranishëm edhe dhjetëra familjarë të

fëmijëve që po prisnin me padurim kthimin e tyre. Në këtë pritje nuk kanë munguar edhe lotët. "Shumë mirë, duhet të

kthehen edhe të tjerët. Po punojmë dhe, më herët se vonë, do të vijmë edhe të tjerët", ka thënë kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama.



Të enjten takimi i radhës në mes të Kosovës dhe Serbisë në nivel ekspertësh

Prishtinë, 27 tetor - Pas më shumë se një muaji, të enjten, më 29 tetor, në Bruksel pritet të zhvillohet takimi i delegacionit të Kosovës dhe atij të Serbisë në nivel ekspertësh, në kuadër të dialogut të ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian. Kështu kanë thënë burimet diplomatike në Bruksel, pa dhënë më shumë hollësi rreth takimit, raporton "REL". Ky takim ishte planifikuar të zhvillohej në fund të muajt shtator, por ishte shtyrë për shkak të masave parandaluese kundër pandemisë së koronavirusit si dhe për shkak të pengesave të paraqitura rreth temave në dialog, për të cilat palët nuk ishin të pajtimit. Kosova në nivel ekspertësh përfaqësohet nga koordinatori shtetëror për

dialogun, Skender Hyseni, ndërkaq Serbia përfaqësohet nga Marko Gjuriq. Sipas burimeve në Bruksel, pritet që temë e diskutimeve që do të zhvillohen të enjten të jenë çështjet financiare dhe pretendimet pronësore të palëve, tema për të cilat ishte diskutuar edhe në takimet e mëhershme. Takimi do të zhvillohet duke respektuar masat e rrepta që kanë vendosur këto ditë autoritetet e Belgjikës, por edhe vetë institucionet e Bashkimit Evropian, për ta frenuar përhapjen e mëtejme të koronavirusit. Dialogu në mes të Kosovës dhe Serbisë ka rinisur gjatë kësaj vere dhe deri më tani janë zhvilluar disa takime si në nivel të lartë ndërmjet kryeministrit të Kosovës, Avdullah Hoti dhe presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq, por edhe



mes delegacioneve në nivel ekspertësh. Por, për më shumë se një muaj nuk ka pasur takime ndërmjet përfaqësuesve të Kosovës dhe Serbisë dhe

njëra prej shkaqeve ishte refuzimi i Kosovës për të biseduar rreth asociacionit të komunave me shumicë serbe në Kosovë dhe insistimi i Serbisë që të bisedohet për

këtë temë si prioritet. Për të përgatitur takime të reja, në Kosovë dhe Serbi, para një jave kishte qëndruar i dërguari i posaçëm i BE-së për dialog, Miroslav Lajçak.

Paralajmërohet formimi i një komisioni hetimor për shuarjen e kësaj Task-Forcës Anti-Korrupsion

EPOKA
ERE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 27 TETOR - Në mbledhjen e së martës të Komisionit për Çështje të Sigurisë dhe të Mbrojtjes, kryesuar nga Fatmire Kollçaku, kryetare e komisionit, është diskutuar lidhur me zhvillimet në Policinë e Kosovës. Kollçaku ka sqaruar fillimisht se i ftuar për raportim në këtë komision ishte ministri i Punëve të Brendshme, Agim Veliu, por ai nuk i është përgjigjur ftesës së komisionit për datat e caktuara, madje as nuk ka përcaktuar ndonjë datë tjetër alternative. Megjithatë, ky komision ka vazhduar diskutimin për temat për të cilat ishte i ftuar ministri Veliu të japë sqarime, duke shprehur kritika për mosraportim të tij në Komisionin për Çështje të Sigurisë dhe të Mbrojtjes. Shkarkimi i drejtorit të Përgjithshëm i Policisë së Kosovës dhe shuarja e Task-Forcës Antikorrupsion ishin çështjet e vetme në të cilat është



fokusuar komisioni, duke shfaqur qëndrime të ndryshme për këto çështje. Më tutje, u dhanë edhe disa propozime lidhur me këtë, me theks të veçantë që të formohet një komision hetimor lidhur me shuarjen e kësaj Task-Forcës

Anti-Korrupsion, ndërkaq pati edhe propozime që komisioni ta ftojë për interpelancë në Kuvend ministrin Veliu për shkak të mosraportimit në komision dhe për zhvillimet në Policinë e Kosovës. Në vijim u kërkua që komisioni

të nënshkruajë për mbajtjen e kësaj interpelance si dhe ta iniciojë çështjen për formimin e komisionit hetimor parlamentar për zhbërjen e Task-Forcës Antikorrupsion. Pas një debati të gjerë, komisioni formoi grupin e


punës lidhur me Projektligjin për deminimin humanitar, ndërkaq u bë me dije se, pas mbledhjes, komisioni do të zhvillojë një vizitë pune në pikën kufitare në Merdar lidhur me zbatimin e marrëveshjeve Kosovë - Serbi.

Hoti zotohet për kthimin e ligjshmërisë dhe të kushtetutshmërisë në vend

Prishtinë, 27 tetor (ER) - Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, në një takim virtual me përfaqësuesin special të BE-së dhe me ambasadorët e vendeve anëtare të Unionit Evropian, shprehu vendosmërinë e

qeverisë për vendosjen e ligjshmërisë dhe për adresimin e të gjitha sfidave për luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit. "Ky takim erdhi pas bashkëbisedimit që kryeministri Hoti, zhvilloi të hënën me ambasadorët e

vendeve të Quintit dhe përfaqësuesin special të BE-së, ku u zotua për thellimin e bashkëpunimit me qeveritë e këtyre vendeve në fushën e sundimit të ligjit", ka njoftuar Zyra për Informim e Qeverisë së Kosovës.



Tre të vdekur dhe 197 raste të reja me Covid në Kosovë gjatë 24 orëve të fundit

PARALAJMËROHEN MASA TË REJA KUNDËR COVIDIT NË KOSOVË

Rritja e numrit të të infektuarve me Covid-19 në javët e fundit ka shtyrë institucionet e vendit të mendojnë për masa të reja për parandalimin e përhapjes së Covid-19. Ministri i

Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka bërë me dije se shumë shpejt qeveria do të dalë me vendime për masa të reja për Kosovën në përgjithësi dhe për Prishtinën në veçanti, e cila është bërë

epiqendër e infeksionit. Në 24 orët e fundit kanë vdekur tre pacientë, ndërkaq janë konfirmuar edhe 197 raste të reja me Covid, 92 prej tyre vetëm në Prishtinë

EPOKA E RE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 27 TETOR - Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka paralajmëruar ndërmarrjen e masave të reja për parandalimin e përhapjes së Covid-19 në vend. Pas takimit me kryetarin e Prishtinës, Shpend Ahmeti, ai ka thënë se shumë shpejt qeveria do të dalë me vendime për masa të reja për Kosovën në përgjithësi dhe për Prishtinën në veçanti, e cila është bërë epiqendër e infeksionit me Covid-19. "Dy javët e fundit Prishtina ka qenë epiqendra e infeksionit në vendin tonë. Ky fakt shqetësues na detyron që shumë shpejt të dalim me vendime për masa të reja për Kosovën në përgjithësi, por për Prishtinën në veçanti. Mbi 700 raste të reja me infeksion gjatë 14 ditëve të fundit në kryeqytet, situatë kjo që kërkon mobilizim maksimal të të gjithëve për t'i zbatuar me përpikëri dhe me rigorozitet vendimet e qeverisë", ka thënë Zemaj pas takimit që ka pasur të martën me të parin e kryeqytetit.

Ai ka kërkuar nga kryetari i Prishtinës që të kenë vëmendje të shtuar në shkolla, në transportin publik dhe në gastronomi. "Nga kryetari i Komunës së Prishtinës, z. Shpend Ahmeti, kërkova që bashkë me shtabet emergjente dhe task forcën, të kenë vëmendje të shtuar në shkolla, në transportin publik, gastronomi dhe kudo që shfaqet rreziku nga virusi Covid-19. Kërkova të zbatohen rreptësisht rekomandimet si mbajtja e distancës fizike, përdorimi i maskave, dezinfektimi dhe ajrosja e lokaleve, për ta pamundësuar përhapjen eventuale të infeksionit në hapësirat e mbyllura", ka vlerësuar Zemaj. Ai ka thënë se Prishtina është kryeqytet i të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës, e cila nuk do të lejohet të jetë vatër e infeksionit.

Ndërsa kryetari i Prishtinës, Shpend Ahmeti, ka deklaruar se numri i lartë i të infektuarve në kryeqytet vjen nga testimet e mëdha që po bëhen. "Me të vërtetë nuk jemi të interesuar

të bëjmë karantinë dhe shkurtojmë orarin e punës, por kjo bëhet vetëm me bashkëpunimin e qytetarëve të Prishtinës. Një krizë e re po vjen. Kriza në Evropë po dërgon drejt mbylljes, ndërsa ne kemi nën 100 raste pozitive për 100 mijë banorë. Pra, ende jemi në zonën e gjelbër", ka deklaruar Ahmeti.

Ai ka treguar se e ka njoftuar ministrin Zemaj edhe për hulumtimin që do të bëhet në kryeqytet në muajin nëntor, ku do të testohen deri në 3 000 persona. "Është një krizë e re. Jemi duke folur për krizë në Evropë që është duke çuar drejt mbylljes. Sot duhet të punojmë bashkë dhe të mos na detyrojnë të bëhemi inspektorë. Nuk do të lejojmë grumbullime në kafe. Numri i testeve në Prishtinë është më i madh. Fokusin e kemi që ta ngadalësojmë këtë virus. Sot e kemi sistemin më të mirë të shkollave gjatë pandemisë. E informova ministrin se për muajin nëntor do t'i testojmë 3 000 qytetarë të Prishtinës. Ky testim po bëhet për hulumtim në mënyrë që të kuptojmë përqindjen e qytetarëve që kanë pasur Covid", ka shtuar Ahmeti.

Situata në spitale, stabile

Për t'u njohur me gjendjen e spitaleve si dhe me përgatitjet për situatën epidemiologjike në vend, ministri Zemaj të martën ka takuar edhe drejtorët e përgjithshëm të spitaleve dhe të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar. Pas takimit me ta, ai ka thënë se situata në spitale është stabile, duke shtuar se institucionet duhet të jenë të vëmendshme. "Përkujdesja shëndetësore nuk bën të mungojë për shkak të virusit. Asnjë kufizim i trajtimit të pacientëve nuk mund të bëhet në spitale e as në QKUK. Spitalet e përgjithshme në asnjë çast nuk mund ta ngarkojnë QKUK-në, duke udhëzuar rastet. Pacientët që mund ta marrin trajtimin e duhur në spitalet rajonale, duhet të mbesin aty", ka shkruar ai në profilin e vet në "Facebook". Ai ka treguar se po hyjnë në fazën e re të përgjithësisë, ku puna



duhet të vazhdojë me përkushtim të lartë. "Tashmë kur po hyjmë në një fazë të re të përgjithësisë, pres nga secili përgjegjës që të jetë në nivelin e duhur, ritmi i punës nuk do të ulet, puna duhet të vazhdojë me përkushtim të shtuar. Kemi shtuar edhe 200 mjekë si dhe 375 staf mbështetës të fushave të ndryshme, ndërsa në specializime edhe rreth 1 500 mjekë të tjerë", ka vlerësuar Zemaj.

Tre të vdekur dhe 197 raste të reja me Covid në Kosovë

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka bërë me dije se në 24 orët e fundit janë shënuar tre të vdekur dhe 197 raste të reja me Covid në Kosovë. Në njoftimin për medie është thënë se gjatë kësaj kohe janë testuar gjithsej 1 018 mostra të marra nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës

(ShSKUK) dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren. "Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në IKShPK dhe laboratorët privatë me metodën RT-PCR janë testuar gjithsej 1 018 mostra të marra nga ShSKUK dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve rezultojnë 197 raste pozitive. Brenda 24 orëve janë raportuar tre raste të vdekjes me SARS CoV-2 pozitiv (2 raste

Mbyllen 14 shkolla, infektohen mbi 250 nxënës dhe mësimitdhënës

Për shkak të paraqitjes së rasteve pozitive me koronavirus, si në mesin e nxënësve ashtu edhe të mësimitdhënësve, 14 shkolla në Kosovë janë mbyllur, kurse mësimi ka vazhduar online. Diellza Kukaj, zyrtare për

informim në Ministrinë e Arsimit dhe të Shkencës, ka deklaruar se numri i nxënësve të infektuar me koronavirus është 130, ndërkaq i mësimitdhënësve 148. “të gjitha shkollat që tashmë janë mbyllur kanë kaluar në planin C, pra

mësimi po mbahet online. Ky është bilanci i të infektuarve që ne e kemi marrë ditën e premte (23 tetor) nga e gjithë Kosova, pra kemi 148 mësimitdhënës dhe 130 nxënës të infektuar”, ka deklaruar Kukaj për “Radion Evropa e Lirë”.



Spitali i Përgjithshëm, Prizren dhe 1 rast Mjekimi Intensiv Qendror, QKUK”, është thënë në njoftimin e IKShPK-së, duke treguar edhe për numrin e pacientëve që janë shëruar. “Numri total i rasteve pozitive është 18 345 raste nga 89 108 persona të dyshimtë me virusin SARS-CoV-2 dhe 669 raste të të vdekurve nga ky infeksion. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 48 pacientë, kurse numri i përgjithshëm i të shëruarve deri

më sot është gjithsej 15 198 raste, ndërsa numri i rasteve aktive është 2 478”, ka njoftuar instituti.

Sipas të dhënave të IKShPK-së, Komuna e Prishtinës vazhdon të jetë e para në listë sa i përket numrit të të infektuarve me Covid. “Rastet pozitive janë nga: komuna Prishtinë 92 raste, komuna Fushë-Kosovë 17 raste, komuna Gjilan 17 raste, komuna Gjakovë 14 raste, komuna Pejë 14 raste, komuna Ferizaj 13

raste, komuna Drenas 4 raste, komuna Klinë 4 raste, komuna Vushtrri 4 raste, komuna Mitrovicë 3 raste, komuna Obiliq 3 raste, komuna Istog 2 raste, komuna e Lipjan 2 raste, komuna Podujevë 2 raste, komuna Prizren 2 raste, komuna Rahovec 2 raste dhe me nga një rast komunat Shtime dhe Viti”, ka njoftuar instituti duke i ftuar qytetarët e Kosovës t'i mbajnë maskat, higjienën dhe mbajnë distancën fizike mes njëri-tjetrit.

Ngrihet aktakuzë kundër 29 personave për pastrim të parave dhe për bixhoz të paligjshëm

PRISHTINË, 27 TETOR (ER) - Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës ka ngritur të martën aktakuzë në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti Special, kundër 29 të pandehurve për veprat penale “Pastrim i parave”, “Organizim i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm” si dhe për veprën penale “Ndihma”. Të akuzuarit e Prokurorisë Speciale janë: S. K., A. D., A. K., Z. Z., B. A., B. B., B. B., F. M., N. P., N. E., N. E., H. E., B. B., T. D., D. Sh., B. S., A. H., A. L., B. I., P. N., A. B., A. R., I. J., I. V., S. B., S. B., R. N., B. M., B. K. “Të pandehurit e lartcekur, duke vepruar qoftë veç e veç apo në bashkëkryerje ashtu siç është përshkruar në pikat e dispozitivit të aktakuzës, nga data e pacaktuar në vazhdimësi deri më 15.12.2017, duke vepruar me dashje dhe dijeni, në kundërshtim me Ligjin për Lojëra të Fatit, gjithnjë me qëllim që vetes t'i sjellin përfitim të kundërligjshëm të dobisë pasurore, organizuan lojëra të fatit për të cilat nuk ka qenë e dhënë licenca, leja apo koncesioni i organit kompetent, në atë mënyrë që me rastin e kontrollimit nga ana e inspektorëve të ATK-së, dhe pjesëtarëve të PK-së/DHKO, në bizneset e të pandehurve janë gjetur dhe konfiskuar automate për të cilat të pandehurit nuk kanë pasur licencë nga organi kompetent apo kanë vepruar në kundërshtim me licencën e dhënë, apo nuk kanë pasur leje nga komuna përkatëse për ushtrimin e asaj veprimtarie”, është thënë në njoftimin e Prokurorisë Speciale të Kosovës.

Po ashtu, nga provat në dispozicion në këtë çështje rezulton se tani të pandehurit e

lartcekur që një periudhë të gjatë kohore janë të përfshirë në aktivitetin kriminal të pastrimit të parave të fituara me anë të veprave penale të lartcekura, ku me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm material, kanë realizuar aktivitetin e tyre kriminal përmes ushtrimit në mënyrë të kundërligjshëm të aktivitetit biznesor të kazinove, gjegjësisht lojërave të fatit, e më pas duke realizuar transaksione të ndryshme financiare nga mjetet e siguruar nga ai aktivitet i tyre kriminal, më saktë nga vepra e ndërlidhur penale e cila të pandehurve iu ka gjeneruar të ardhura në shumta të larta milionëshe për rrjedhojë, kështu duke u përmbushur në tërësi elementet e veprës penale të shpëlarjes së parasë (sipas specifikohet në Ligjin për Parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit), duke përfshirë: Vendosjen, shtresëzimin dhe integrimin përmes futjes dhe rifutjes së mjeteve të paligjshme në ekonominë e vendit si të ardhura të ligjshme, siç specifikohet në nenin 308 të KPRK-së dhe në nenet 56 dhe 57 të Ligjit 05/L-096 mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimit të terrorizmit. “Me këto veprime të pandehurit e lartcekur kanë kryer veprat penale ‘Pastrimi i parave’, ‘Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm’ si dhe për veprën penale ‘Ndihma’. Në aktakuzë i është propozuar gjykatës që pas administrimit të provave dhe përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, të pandehurit, për veprat penale që akuzohen, t'i shpallë fajtorë dhe t'i gjykojë sipas ligjit”, është theksuar në njoftimin e Prokurorisë Speciale të Kosovës.



AGK-ja publikon hulumtimin 'Ndikimi i pandemisë Covid-19 në gjendjen ekonomike të gazetarëve'

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 27 TETOR - Asociacioni i Gazetarëve i Kosovës (AGK), me mbështetjen e Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS), ka publikuar të martën hulumtimin "Ndikimi i pandemisë Covid-19 në gjendjen ekonomike të gazetarëve, kameramanëve dhe fotoreporterëve".

Hulumtimi është realizuar nga hulumtuesja Lirika Demiri dhe fokusohet në largimet nga puna dhe zvogëlimi i pagave të gazetarëve, ndikimin e Pakos Emergjente në sektorin e mediave si dhe mirëqenien fizike dhe mendore të punëtorëve medialë gjatë periudhës së pandemisë Covid-19.

Drejtoresha ekzekutive e Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës, Getoarë Mulliqi-Bojaj, shprehu falënderimin në emër të AGK-së për pjesëmarrjen e panelistëve, mediave, si dhe për përkrahjen e dhënë nga KFOS-i gjatë kohës së pandemisë, gjë që ka qenë shumë e rëndësishme për komunitetin e gazetarëve, fillimisht për sigurimin e mjeteve mbrojtëse e pastaj edhe për përkrahjen e këtij hulumtimi, i cili vë në pah gjendjen e gazetarëve,

kameramanëve dhe fotoreporterëve në kohë të pandemisë. "Ky raport ka për qëllim ta shpalosë gjendjen ekonomike apo ndikimin të cilin e ka pasur pandemia Covid-19 në gjendjen ekonomike të gazetarëve, kameramanëve dhe fotoreporterëve. Me KFOS-in ka qenë bashkëpunimi i parë fare në fillim të pandemisë kur kemi kërkuar ndihmë nga ai që të sigurojë mjete mbrojtëse për anëtarët tanë, gjegjësisht gazetarët, kameramanët dhe fotoreporterët, të cilët kanë qenë në vijën e parë të frontit duke u përballur me një të panjohur", ka thënë Mulliqi-Bojaj.

Ndërsa hulumtuesja e raportit, Lirika Demiri, shpalosi para të pranishmëve të gjeturat e raportit. "Raporti është rezultat i një hulumtimi që është zhvilluar prej muajit qershor të këtij viti deri në fund të muajit shtator. Kemi realizuar një anketë online me rreth 120 punonjës medialë - gazetarë, kameramanë dhe fotoreporterë, dhe kemi marrë përgjigjet e tyre që kanë të bëjnë kryesisht me ndikimin e pandemisë në gjendjen ekonomike të punonjësve medialë, si dhe me ndryshimin e dinamikës dhe vështirësitë e hasura gjatë raportimit në pandemi. Përveç anketës, ne kemi zhvilluar edhe intervista me gazetarë të ndryshëm dhe



me profesionistë të fushës së medias", ka thënë Demiri. Pjesë e panelit të diskutimit ishin edhe gazetarët Jehona Zhitia dhe Bujar Vitija. Gazetarja Zhitia tregoi disa nga sfidat me të cilat janë përballur gazetarët gjatë raportimit për pandeminë Covid-19. "E kemi nisur këtë sfidë pa ditur se çfarë na pret gjatë rrugës. Pavarësisht prej përvojës së gjatë që mund të kesh në media, ne jemi më të rinj në moshë dhe nuk na ka rastisur që të raportojmë në ndonjë

situatë të ngjashme shëndetësore. Ndonëse edhe vetë mjekët e kishin shumë të panjohur atë se çfarë do të ndodhë në ditët në vazhdim, kjo bëhej edhe më e vështirë ndoshta për neve si gazetarë, për formën tonë të raportimit se çfarë do të themi në fillim. Konsideroj se ishte sfidë edhe për gazetarët, megjithatë ia dolëm që ta bënim punën më së miri", ka thënë ndër të tjera ajo.

Vitija foli për rolin e mediave dhe të gazetarëve për

menaxhimin e pandemisë. "Roli e mediave ka qenë mjaft i rëndësishëm. Gazetarët asnjëherë nuk kanë hezituar që ta kryejnë punën e tyre me përgjegjësi në luftimin e lajmeve të rrejshme. Rreth 30 për qind e qytetarëve nuk kanë besuar në ekzistencën e Covid-19 dhe kjo e ka vështirësuar në masë të madhe menaxhimin e pandemisë nga institucionet. Rol të rëndësishëm për ta përmbytur këtë sondazh kanë luajtur mediat dhe gazetarët", ka thënë Vitija.

Selimi viziton Dhomën e Posaçme, interesohet për zvogëlimin e lëndëve të grumbulluara

PRISHTINË, 27 TETOR (ER) - Ministri i Drejtësisë, Selim Selimi, ka takuar të martën kryetarin e Gjykatës Supreme, Enver Peci dhe ushtruesin e detyrës së gjyqararit mbikëqyrës të Dhomës së Posaçme, Ilmi Bajrami. Gjatë këtij takimi është diskutuar për bashkëpunimin, mbështetjen dhe për mundësinë e krijimit të kushteve për zvogëlimin e numrit të lëndëve në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme. "Pavarësisht prej sfidave që kanë gjyqtarët e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme,



aty është shtuar efikasiteti, mirëpo ende duhet shumë punë. Që të çlirohet kapitali për ekonominë e tregut të lirë, këta

gjyqtarë duhet t'i përkrahim me staf mbështetës dhe gjyqtarë të rinj", ka thënë ministri Selimi. Ministri Selimi ka shprehur

gatishmërinë për krijimin e një fondi emergjent nga Qeveria e Kosovës, përmes të cilit do të krijoheshin mundësitë për zvogëlimin e lëndëve në këtë gjykatë, duke shtuar numrin e gjyqtarëve dhe të bashkëpunëtorëve profesionalë. "Me kryetarin e Gjykatës Supreme, Enver Pecin dhe me u. d. gjyqtar mbikëqyrës i Dhomës së Posaçme, Ilmi Bajrami, u pajtuam që mbështetja më e madhe ndaj tyre mund t'i sjellë shtetit rreth 300 milionë euro para të cilat po qëndrojnë të bllokuara", ka

theksuar Selimi. Ministri Selimi garantoi për mbështetjen e tij në fuqizimin e të gjitha niveleve të gjykatave, sigurimin e pavarësisë së tyre, si dhe rritjen e profesionalizmit dhe integritetit. Ndërsa kryetari i Gjykatës Supreme, Enver Peci dhe ushtruesi i detyrës së gjyqararit mbikëqyrës i Dhomës së Posaçme, Ilmi Bajrami, shprehën gatishmërinë për të punuar bashkërisht për zvogëlimin e lëndëve në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës.

Hoti bëri homazhe te shtatorja e Ukë Bytyçit

SUHAREKË, 27 TETOR (ER) - Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, i shoqëruar nga zëvendëskryeministri Driton Selmanaj, ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, si dhe kryetari i

Komunës së Suharekës, Bali Muharremaj, ka vendosur të martën kurora me lule te shtatorja e Ukë Bytyçit, me rastin e 18-vjetorit të vrasjes së tij. "Ngjarja që ka ndodhur atëherë vërtet ka qenë

goditje e rëndë për votën e lirë, për demokracinë, për familjen dhe për bashkëpunëtorët e tij. Fakti që gjatë gjithë këtyre viteve, çdo qytetar i Suharekës, çdo qytetar i Kosovës dhe

bartësit e institucioneve të nivelit qendror dhe lokal tregojnë respektin e vazhdueshëm për të, tregon sa njeri i madh ka qenë Ukë Bytyçi", ka thënë kryeministri Hoti.



Lëvizja FOL: Komunat nuk treguan transparencë në planet e tyre të veprimit

Lëvizja FOL ka publikuar raportin "Transparenca komunale" për vitin 2019-2020 në pesë komuna të Kosovës: Klinë, Istog, Pejë, Deçan dhe Gjakovë, për periudhën janar 2019 - qershor 2020. Qëllimi i këtij raporti është vlerësimi i shkallës së përmbushjes së obligimeve komunale të transparencës dhe përfshirjes së qytetarisë aktive. Sipas Lëvizjes FOL, komunat nuk kanë treguar transparencë në planet e tyre të veprimit



fundit kanë informacionet e duhura, mund t'i delegojnë kërkesat e tyre siç duhet.

Kujtim Gashi, drejtor i Agjencisë i Shoqërisë së Informacionit, ka thënë se komunat gjatë kohës së fundit kanë bërë kalimin nga një operator i cili mundësonte përdorimin e komunave për përdorimin e sistemit të intranetit, i cili, po ashtu, mirëmbante faqet zyrtare me përditësime. "Sa është dekurajues fakti i mosrespektimit të plotë të elementeve të udhëzimit administrativ mbi mirëmbajtjen e faqeve zyrtare, më inkurajues është fakti se shumica e komunave i plotësojnë pothuajse të gjitha elementet, kështu shohim tentimin e respektimit të udhëzuesit. Monitorimi nga Ministria e Pushtetit Lokal, por edhe nga projektet si ky, ndikojnë pozitivisht dhe japin një shtytje që komunat ta japin maksimumin e kapaciteteve të tyre për përmbushjen e detyrimeve", ka thënë Gashi.

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 27 TETOR - Lëvizja FOL, me mbështetjen e Friedrich Ebert Stiftung (FES), ka mbajtur të martën diskutimin online, me ç'rast ka publikuar raportin "Transparenca komunale". Ky raport përfshinë gjetjet nga monitorimi i publikimit të planeve të veprimit të transparencës komunale dhe kalendarin e punës për vitin 2019-2020 në pesë komuna të Kosovës: Klinë, Istog, Pejë, Deçan dhe Gjakovë, për

periudhën janar 2019 - qershor 2020.

Qëllimi i këtij raporti është vlerësimi i shkallës së përmbushjes së obligimeve komunale të transparencës dhe përfshirjes së qytetarisë aktive. Alba Jakupi nga Lëvizja FOL ka thënë se përmes publikimit të planeve të veprimit të transparencës komunale dhe kalendarit të punës, promovohen qytetaria aktive dhe llogaridhënia komunale, duke ofruar kështu mundësi të përfshirjes së qytetarëve për mbarëvajtjen e proceseve të ndryshme nga vetë komunat.

"Përmes analizimit të planit të veprimit për transparencë të vitit 2019-2023, me ndarjen e objektivave dhe aktivitetëve, është bërë i mundur vlerësimi i përmbushjes së këtyre objektivave. E vetmja komunë e cila nuk ka plan të veprimit është Gjakova. Zyrtarët komunalë për informim përmes email-it na bënë të ditur se një plan i tillë është në hartim e sipër për Komunën e Gjakovës, ani pse një gjë e tillë duhej të publikohej më shumë se një vit e gjysmë më parë", ka thënë

Jakupi. Sipas saj, përmes pyetësorit për zyrtarët komunalë kanë marrë përgjigje rreth të dhënave komunale për transparencë, të cilat, po ashtu, janë krahasuar me gjetjet gjatë monitorimit të uebfaqeve të pesë komunave: Klinës, Istogut, Pejës, Deçanit dhe Gjakovës. Mejreme Asllani nga FES-i ka thënë se transparenca është një ndër parimet kyçe të demokracisë dhe funksionimit adekuat të komunave, sidomos në lidhshmëri me qytetarët pasi që në momentin kur këta të

Gjermania dhuron 15 vetura të reja për Policinë e Kosovës

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 27 TETOR - Policia Federale e Gjermanisë të martën, në një ceremoni të organizuar në ambientet e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Kosovës, ka bërë dhurimin e një donacioni të rëndësishëm prej 15 veturave për Policinë Kufitare të PK-së. Pranindorëzimi i këtij donacioni u nënshkrua nga u. d. drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Samedin Mehmeti dhe ambasadori i Gjermanisë në Kosovë, Jorn Rohde. Ky donacion, sipas Mehmetit, dëshmon bashkëpunimin e fuqishëm të Policisë së Kosovës me atë të Gjermanisë, në luftimin e krimit të organizuar dhe atij trans-kufitar. Si shumë të rëndësishëm këtë donacion e ka cilësuar edhe ambasadori i

Gjermanisë në Kosovë, Jorn Rohde, i cili rikonfirmoi bashkëpunimin dhe përkrahjen e vazhdueshme për Policinë e Kosovës, në veçanti për Policinë Kufitare.

Pesëmbëdhjetë automjetet që erdhën si dhuratë janë të modelit "Duster" nga prodhuesi "Dacia", veturë kjo e cila dallohet për multi-funksionalitetin teknologjik, ashtu sikurse për qasjen e mirë në terrene të ndryshme pavarësisht prej vështirësisë, e që janë të nevojshme për Policinë Kufitare. Ushtruesi i detyrës së drejtorit të PK-së, Samedin Mehmeti, ka falënderuar ambasadorin gjerman dhe Policinë Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin, përkrahjen dhe mbështetjen e vazhdueshme që shteti gjerman ka bërë dhe po bën ndaj Policisë së Kosovës.

Edita Tahiri kujton nënshkrimin e MSA-së: Nuk punuam si duhet për t'i përmbushur obligimet

PRISHTINË, 27 TETOR (ER) - Ish-zëvendëskryeministrja dhe ish-ministrja për Dialog, Edita Tahiri, ka publikuar një fotografi në llogarinë e vet në "Facebook", mbi të cilën ka shkruar se pesë vjet më parë ishin shumë të gëzuar kur u nënshkrua Marrëveshja e Stabilizim

Asocimit për Kosovën, raporton "Epoka e re". "Ishim shumë të gëzuar pesë vjet më parë kur e nënshkruam Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit që vendosi Kosovën në rrugën zyrtare të integritimit evropian, por nuk punuam si duhet për t'i përmbushur obligimet që sot do

t'i mundësonin Kosovës hapjen e rrugës për anëtarësim. Dhe kjo punë ka qenë e jona, e institucioneve të Kosovës. Derisa me të drejtë fajësojmë BE-në për mosliberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës, për punën e MSA-së fajet dhe dështimet janë tonat", ka shkruar Edita Tahiri.



Komisioni për Ekonomi takoi përfaqësuesit e MCC-së, bisedohet për sektorin e gazit

PRISHTINË, 27 TETOR (ER) - Komisioni për Ekonomi, Punësim, Tregti, Industri, Ndërmarrësi dhe Investime Strategjike, i udhëhequr nga Endrit Shala, kryetar, ka pritur të martën në takim

Sarah Ohmstead, shefe e MCC-së për Kosovë. Në këtë takim u diskutua lidhur me zhvillimin e sektorit të gazit në Kosovë. Projekt ky për gazifikimin e Kosovës përmes Maqedonisë së

Veriut, balancimi i sistemit të transmisionit - investime në sistemin e rezervës primare dhe sekondare për KOSTT dhe komponenti i fuqizimit të sektorit të energjisë në Kosovë.



Një muaj paraburgim për pronarin e kompanisë ku u transferuan mbi 2 milionë euro

PRISHTINË, 27 TETOR - Gjykata Themelore në Prishtinë ka caktuar masën e paraburgimit prej një muaji për të pandehurin K. Sh., i cili dyshohet se ka kryer veprën penale, pastrim i parave. K. Sh., i cili është vetëdorëzuar një ditë më parë, besohet se është pronar i kompanisë "LDA Group", ku punonjësi i Thesarit të Kosovës, Labinot Gruda, përmes katër transferimeve ka dërguar mbi 2 milionë euro. "Gjyqtari i procedurës paraprake pas mbajtjes së seancës dëgjimore dhe pas analizimit të shkresave të lëndës gjeti se kërkesa e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës për caktimin e paraburgimit është e bazuar dhe paraburgimi i është caktuar në bazë të nenit 187", është thënë në njoftimin për media të kësaj gjykate.

Aty është thënë se masa e paraburgimit është caktuar meqë i dyshuari mund të arratiset me qëllime të shmangies së përgjegjësisë penale. Përveç të dyshuarit me inicialet K. Sh., Policia e

Kosovës ka thënë se edhe pronari tjetër i kompanisë LDA Group, me inicialet V. Sh. është i dyshuar, por është në arrati. Përndryshe, Gjykata Themelore në Prishtinë, më 22 tetor, i ka caktuar edhe Labinot Grudës masën e paraburgimit prej një muaji.

Prokuroria e Kosovës pretendon se Gruda i ka bërë transferimet në vlerë të mbi 2 milionë eurove më 9 tetor, ndërsa është arrestuar më 20 tetor. Sipas organit të hetuesisë, Gruda i ka bërë këto veprime në një periudhë prej 8 minutash.

Ministrja e Financave në Qeverinë e Kosovës, Hykmete Bajrami, ka deklaruar se transferimi i mbi 2 milionë eurove është bërë përmes një sulmi kibernetik. "Ky është krim ekonomik, i realizuar përmes një krimi të thellë kibernetik, ku janë bërë qasje të paautorizuara, janë tejkuluar autorizimet ligjore, është bërë keqpërdorim i detyrës zyrtare dhe janë thyer fjalëkalimet", ka deklaruar ministrja Bajrami.

Kompania "LDA Group", sipas



Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve, është regjistruar si biznes në gusht të vitit 2019. Si pronarë të këtij biznesi figurojnë K. Sh dhe V. Sh.,

ndërsa si veprimtari kryesore e ka të përcaktuar ndërtimin e objekteve banesore dhe jobanesore, ndërsa veprimtari dytësorë demolin e

objekteve. Sipas të dhënave të kësaj agjencie, kjo kompani e ka adresën në fshatin Llapushnik të Gllgovcit, rreth 30 kilometra nga Prishtina.

Fillon pagesa e subvencioneve



PRISHTINË, 27 TETOR (ER) - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural tanimë ka filluar realizimin e

pagesave direkte apo subvencioneve. Këtë e bëri me dije ministri i MBPZhR-së, Besian Mustafa, i cili tha se

pagesa e subvencioneve sivjet do të bëhet dy herë në krahasim me vitin 2019. Sipas ministrit Mustafa, për të

gjitha kulturat dhe për të gjitha masat pagesa do të bëhet dy herë. Ai ka sqaruar se fillimisht do të paguhet

pjesa e parë sipas programit të rregullt, kurse pasi të jenë paguar subvencionet për të gjithë fermerët, do të fillojë të bëhet edhe pagesa e dytë e subvencioneve për të gjithë përfituesit.

Ministri Mustafa ka thënë se përkrahja ndaj fermerëve ka për qëllim kthimin e vitit 2020 nga një vit plot sfida për bujqësinë, në një vit të fuqishëm për bujqësinë e Kosovës. Vendimi për dyfishimin e subvencioneve për të gjitha kulturat u soll si pjesë e Pakos për Rimëkëmbje Ekonomike. Ky vendim ishte kundërpërgjigje e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për t'u dalë në ndihmë fermerëve të Republikës së Kosovës për ta përballuar goditjen që shkaktoi pandemia Covid-19.

Reçica në Tiranë: Regjioni të punojë më shumë për integrimin e komuniteteve pakicë

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

TIRANË, 27 TETOR- Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica të martën mori pjesë në takim ministror të vendeve të Ballkanit Perëndimor, për integrimin e romëve në shoqëri, në kuadër të procesit të Berlinit, që këtë radhë po organizohet nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë, me mbështetje të Këshillit për Bashkëpunim Rajonal (RCC).

Ky takim ministror ishte një mundësi e mirë për të vënë në pah gjithë angazhimin dhe përkushtimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës në funksion të zbatimit të Deklaratës së Partnerëve të Ballkanit Perëndimor për Integrimin e Romëve, Ashkalive dhe Egjiptianëve në shoqëritë e vendeve tona.

Reçica ka njoftuar pjesëmarrësit e këtij takimi ministror për hapat konkret që ka ndërmarrë Qeveria e Kosovës në zbatim të Deklaratës së Partnerëve të Ballkanit Perëndimor për Integrimin e Romëve, konkretisht për themelimin e Grupit Teknik për Mbrojtjen nga Diskriminimi të Komuniteteve Romë, Ashkali

dhe Egjiptianë, që është edhe përgjegjëse për të zbatuar përgjegjësitë që dalin nga Deklarata e Partnerëve të Ballkanit Perëndimor për Integrimin e Romëve, në kuadër të procesit të zgjerimit të Bashkimit Evropian. “Ne si shoqëri jemi përgjegjës për të përfshirë komunitetet në sistemin e edukimit dhe arsimit profesional, me qëllim që të kenë më pas qasje në tregun e punës”, ka thënë ministri Reçica, duke theksuar se sa i përket integrimin në punësim, tashmë është e evidente se Kosova po ballafaqohet me papunësi të lartë. “Këtë situatë e ka vështirësuar edhe më tej pandemia Covid-19”, ka thënë ai.

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale gjithashtu me programet saj të Masave Aktive të Tregut të Punës, me të cilat ka filluar tashmë, këtë vit, në mënyrë proporcionale do të jenë të përfshirë të gjitha komunitetet dhe atë në komunat e tyre: në arsim profesional, punë publike, praktikë në punë etj. “Me këtë rast u bëj thirrje pjesëtarëve të komunitetit Romë, Ashkali, Egjiptianë që të regjistrohen në zyrat e punësimin, me qëllim të shfrytëzimit të



shërbimeve publike të punësimin, me ç'rast do të përfitojnë nga masat aktive të tregut të punës të ofruara nga ne”, u ka thënë ministri Reçica. Ai, gjithashtu ka potencuar se gjatë vitit 2019 dhe 2020 Qeveria e Kosovës ka mbështetur komunitetet Romë, Ashkali, Egjiptianë në ndërtimin e shtëpive, ku janë në ndërtim e sipër rreth 170 shtëpi dhe projekte të tilla do

të vazhdojnë edhe në të ardhmen, me qëllim që secili qytetar të ketë strehë mbi kokë. Me qëllim të rritjes së mirëqenies së qytetarëve, Qeveria e Kosovës ka miratuar Koncept Dokumentin për Asistencën Sociale, si program i vetëm i mbrojtjes sociale në vend dhe me këtë rast do të përfitojnë komunitetet romë, ashkali, egjiptianë, sepse ju

ofron atyre më shumë mbrojtje sociale dhe nuk lejon diskriminim me kriteret e përfutimit.

Në fund të fjalës së tij, Reçica ka thënë se është domosdoshmëri e kohës që të kemi një përkushtim të madh si regjion, në mënyrë që të bëjmë më të mirën për integrimin e romëve, ashkalive dhe egjiptianëve në shoqëritë e Ballkanit Perëndimor.

Delegacioni i BQK-së përfundoi pjesëmarrjen në takimet vjetore virtuale të FMN-së dhe të BB-së

PRISHTINË, 27 TETOR (ER) - Banka Qendrore e Kosovës (BQK) ka qënë pjesë e takimeve vjetore të Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe të Bankës Botërore që këtë vit u organizuan nga distanca për shkak të pandemisë Covid-19. Gjatë këtyre takimeve, të cilat u zhvilluan nga data 15 deri më 22 tetor 2020, guvernatori Mehmeti mori pjesë edhe në takim të Konstituencës së Fondit Monetar Ndërkombëtar, pjesë e së cilës është edhe Kosova.

Gjithashtu, guvernatori Mehmeti ka realizuar takim edhe me zëvendës-presidenten e Bankës Botërore, Anna Bjerde dhe ekipin e saj, ku janë diskutuar zhvillimet e fundit makroekonomike në Kosovë, si dhe kërkesat për asistencë teknike.

Guvernatori Mehmeti me këtë rast njoftoi zëvendës-presidenten e Bankës Botërore lidhur me sistemin financiar në vend dhe masat e

ndërmarra nga ana e BQK-së gjatë kohës së pandemisë. Gjatë këtyre takimeve virtuale guvernatori Mehmeti dhe përfaqësuesit e BQK-së morën pjesë në takimin e drejtoreshës menaxhuese të Fondit Monetar Ndërkombëtar, të cilën e zhvilloi me ministrat dhe guvernatorët e Evropës Qendrore dhe Lindore.

Në këtë takim, përveç prezantimit të perspektivës ekonomike evropiane, u diskutua edhe për sfidat dhe politikën që ndërlihen me përgjigjen ndaj efekteve të Covid-19. Përfaqësuesit e BQK-së morën pjesë edhe në takim të Komitetit Monetar Financiar Ndërkombëtar të Fondit Monetar Ndërkombëtar, ku u diskutuan tema të ndryshme që kanë të bëjnë me adresimin e pandemisë, promovimin e rimëkëmbjes së qëndrueshme gjithëpërfshirëse dhe ringjalljen e bashkëpunimit global.



Komuna e Skenderajt dhe 'Qatar Charity mbështesin familjet në nevojë

SKENDERAJ, 27 TETOR (ER) - Komuna e Skenderajt në bashkëpunim me organizatën "Qatar Charity" kanë shpërndarë grante për fermerët e Skenderajt. Në kuadër të këtyre granteve janë përfshirë gjashtë multikultivatorë dhe një kosë bari për shtatë familje në nevojë të kësaj komune.

Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, në emër të qytetarëve të Skenderajt, ka shprehur mirënjohje për organizatën "Qatar Charity", për përkrahjen e dhënë në vazhdimësi për qytetarët e

komunës.

Edhe drejtori i Drejtorisë për Bujqësi, Sokol Sallahu, ka falënderuar organizatën për bashkëpunimin si dhe ka përgëzuar fermerët përfitues, duke i uruar që të arrijnë suksese në angazhimet e tyre rreth bujqësisë. Këto grante të shpërndara janë në kuadër të memorandum bashkëpunimit, të nënshkruar nga kryetari Jashari dhe drejtori i organizatës Mahmoud Abbas Shaker, përmes të cilit janë ndihmuar familjet në kushte të rënda ekonomike, me



ndarjen e 50 granteve në vlerë totale prej 75.000.00 eurosh.

Nga ky memorandum, komuna,

në bashkëpunim me organizatën, kanë dhuruar 23 sera bujqësore, 20 shoqëri bletësh, 6

multikultivatorë dhe një kosë, ku si qëllim kryesor është fuqizimi i ekonomik i familjeve në nevojë.

Komuna e Malishevës dhe FKEE-ja, marrëveshje për tri projekte infrastrukturore

MALISHEVË, 27 TETOR (ER) - Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë (FKEE) dhe Komuna e Malishevës kanë nënshkruar një marrëveshje për tri projekte në fushën infrastrukturore.

Kjo marrëveshje është nënshkruar nga kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj dhe drejtori menaxhues FKEE-së, Admir Shala.

Palët janë marrë vesh që ta iniciojnë implementimin e projekteve në Shtëpinë e Kulturës "Tahir Sinani", ndriçimin publik në rrugën "Adem Jashari" dhe Sallën e Sportit "Habib Zogaj".

Kryetari i Malishevës, Ragip Begaj, me bashkëpunëtorët, drejtorin e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, Rexhep Mazreku, drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Milazim Morinën dhe



Zyrtarin, Fadil Shala, kanë shprehur gatishmërinë për bashkëpunim me përfaqësuesit e FKEE-së për projektet që përfitojnë qytetarët e Malishevës, si dhe kanë falënderuar Asociacionin

Ndërkombëtar për Zhvillim (IDA) dhe Programin për Partneritet të Bankës Botërore, pjesa e III për Evropën dhe Azinë Qendrore, që janë duke i realizuar projektet në këtë komunë.

Koordinohen për luftimin e Covidit në Mitrovicë

MITROVICË, 27 TETOR (ER) - Drejtori i Inspeksionit, Fidan Ademi, ka pritur në një takim pune komandantin e Policisë së Stacionit Jugor në Mitrovicë, Ahmet Xhosha, kryeinspektorin e Inspektoratit të Punës, Nexhat Fazliu, si dhe koordinatoren rajonal të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, Xhemajl Dervishi. Qëllimi i këtij takimi ishte koordinimi lidhur me

realizimin e aksioneve të përbashkëta me qëllim të parandalimit të virusit Covid-19 në Mitrovicë si dhe për zbatimin e duhur të masave mbrojtëse. Me këtë rast, aktorët e institucioneve në fjalë janë marrë vesh për bashkëpunim të ndërsjellët, në mënyrë që situata me këtë virus të jetë e menaxhueshme sa më mirë dhe të respektohet në përpikëri nga qytetarët mitrovicas.



Gjilani shpërndan gjedhe për fermerët gjilanas

GJILAN, 27 TETOR (ER) - Drejtoria e Bujqësisë në Gjilan ka shpërndarë të martën pesë krerë gjedhe për fermerët që janë donacion i shkollës së agrobiznesit "Arbëria".

Drejtori i Bujqësisë në Gjilan, Ramiz Ramadani, ka thënë se këto gjedhe i dedikohen përmirësimit racor dhe në asnjë mënyrë nuk lejohet shitja, therja apo tjetërsimi i tyre. "Ky është kontingjenti i tretë që po e shpërndajmë sot me gjedhe. Pra, 15 ekonomi bujqësore e kanë mundësinë e përmirësimit racor. Industria e mishit në Gjilan, përkatësisht Malësia e Kalabria si dhe industria e qumështit 'Kabi', i japin mundësi të pakufizueshme zhvillimit të këtij sektori. Ne si drejtori po bëjmë përpjekje që ta mbështesim këtë sektor, qoftë

përmes realizimit të programeve në partneritet me shkollën 'Arbëria' dhe programeve të tjera", ka thënë Ramadani.

Ndërsa drejtori i shkollës së agrobiznesit "Arbëria", Xhelal Jetishi, ka thënë se ky donacion i sotëm është edhe një vlerë e shtuar e kësaj shkolle. "Ne kemi hyrë në listën e donatorëve të Drejtorisë e Bujqësisë. Brenda dy vjetëve kemi arritur që t'i shpërndajmë 15 krerë gjedhe për përmirësim racor, pasi për këtë racë kanë nevojë Gjilani dhe Anamorava", ka thënë Jetishi.

Ramadani dhe Jetishi e kanë falënderuar në fund kreun e Gjilanit, Lutfi Haziri, për mbështetjen e madhe të ofruar për realizimin e suksesshëm të këtyre veprimtarive.



Standardet e dyfishta të Gjykatës Speciale të 'Kosovës' në Hagë!

Reagim i KMDLNj-së



Zyra e Prokurorit të Specializuar dhe Dhomat e Specializuara me seli në Hagë e që janë sinonim i një Gjykate Speciale për Kosovën, përkatësisht për krimet e pretenduara të UÇK-së gjatë dhe pas Luftës së Parë botërore, gjatë dhe pas Luftës së Dytë Botërore e sidomos gjatë dhe pas luftës së fundit në Kosovë, nominalisht llogariten të jenë pjesë e sistemit të drejtësisë në Kosovë dhe rrjedhimisht edhe duhet të punojnë sipas ligjeve në fuqi në Kosovë. Së paku ashtu deklarohen të gjithë dhe se kjo gjykatë e specializuar është e Kosovës për faktin se është votuar nga deputetët e Kuvendit të Kosovës dhe se thirret në ligjet e Kosovës. Kjo është ajo ana mashtruese e medaljes, kurse realiteti është se kjo gjykatë është themeluar në rrethana të një presioni të madh dhe terrorizues ndaj deputetëve që është menduar se nuk do ta votojnë dhe se me Kosovën e ka të vetmen lidhje sepse të arrestuarit, të akuzuarit dhe të dënuarit e mundshëm janë të gjithë shqiptarë kurse pala akuzuese,

administrative, ekzekutive janë 100 për qind ndërkombëtarë sikur që edhe paraburgimi dhe mbajtja e dënimit nuk bëhet në institucionet përkatëse të Kosovës por në Hagë. Deri më tani kjo gjykatë ka qenë krejtësisht jotransparente, nga aspekti i të drejtave të njeriut e dhunon universalitetin e të drejtave të njeriut të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut e Kombeve të Bashkuara, siguron drejtësi për viktima sipas parimit etnik sikur edhe përgjegjësi penale gjithashtu sipas parimit etnik. Kjo gjykatë në mënyrë flagrante e dhunon njëri ndër shtyllat kryesore të Drejtësisë Transicionale, e drejta për drejtësi për të gjitha viktimat dhe e drejta për mospërsëritje të krimit. Kjo gjykatë, duke i shpërfillur kompetencat e institucioneve të Kosovës (Gjykata Kushtetuese dhe Institucioni i Avokatit të Popullit) formon institucione paralele në Hagë në ndërkohë që asnjë Gjykatë Ndërkombëtare për Krime Luftë nuk ka pasur as Gjykatë Kushtetuese e as Avokat të

Popullit. As Tribunali për Krime Luftë për ish-Jugosllavinë në Hagë nuk ka pasur Gjykatë Kushtetuese e as Avokat të Popullit brenda saj dhe, krahasuar me Gjykatën Speciale "të Kosovës" në Hagë ka qenë shumë më gjithëpërfshirëse në sigurimin e drejtësisë për viktima dhe përgjegjësisë për ata që kanë bërë krime duke e përjashtuar kriterin etnik gjatë ndarjes së drejtësisë.

Para gjashtë (6) muajve kjo gjykatë përkundër praktikave të mëparshme e bëri publike një propozim aktakuzë kundër presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi dhe liderit të PDK-së, ish-kryetarit të Kuvendit, Kadri Veseli duke e arsyetuar këtë veprim paragjykes me Rregulloren e kësaj gjykate dhe duke listuar arsye që konsideronin si arsyetim juridik për këtë paragjykim të rastit dhe duke ua shkelur në mënyrë flagrante të drejtat e njeriut të Hashim Thaçit dhe Kadri Veseli sepse veçuan vetëm emrat e tyre në ndërkohë që nuk përmendën asnjë emër tjetër. Në atë kohë, i ashtuquajturit Avokat i

Popullit i kësaj gjykate nuk reagoi fare e as Gjykata Kushtetuese. Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi shkeli Kushtetutën e Kosovës për faktin se kërkoi interpretim nga Gjykata Kushtetuese e Gjykatës Speciale për vazhdimin e mandatit të skaduar në ndërkohë që, nëse kjo gjykatë qenka themeluar dhe vepron sipas ligjeve të Kosovës, adresa e kërkimit të interpretimit kushtetues është dashur të jetë Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Sipas Kushtetutës së Kosovës, presidenti i Kosovës në çdo rast kur e vlerëson se duhet sqarim apo interpretim nga Gjykata Kushtetuese, mund të bëjë këtë prandaj është i habitshëm dhe i papranueshëm reagimi historik i kësaj gjykate kinse presidenti Thaçi po përpiket ta zhbëjë këtë gjykatë. Nëse Gjykata Speciale është pjesë e sistemit të drejtësisë në Kosovë dhe se funksionon sipas ligjeve të Kosovës atëherë sipas parimit si është themeluar, sipas të njëjtit parim mund edhe të zhbëhet. Kështu veprohet në shtetet normale ndërsa në shtetet e kolonizuara përjashtohet kjo e drejtë e garantuar me Kushtetutë. Sipas Rregullores së Gjykatës Speciale brenda gjashtë muajve duhet të konfirmohet apo të hidhet poshtë aktakuza e propozuar nga Prokuroria, përjashtuar këtu disa raste specifike. Po e njëjta Gjykatë Speciale, pas kalimit të afatit gjashtëmuajorë nuk është deklaruar dhe arsyetohet ngjashëm sikur në kohën kur kishte bërë publik propozim aktakuzën kundër Hashim Thaçit dhe Kadri Veseli. Atëherë bëri shumë zhurmë kurse tash heshtë që është dhunim i primeve dhe zbatim

i standardeve të dyfishta. As tash nuk dëgjohej i ashtuquajturit Avokat i Popullit i kësaj gjykate dhe se çdo përpjekje të kërkohen sqarime, interpretohet si veprim kundër kësaj gjykate.

Sipas ligjeve në fuqi në Kosovë gjuhë zyrtare janë gjuha shqipe, serbe dhe gjuha e pakicave në rast se i plotësojnë kushtet e parapara me ligj për gjuhët zyrtare. Ndërkaq, Gjykata Speciale e shkel në mënyrë të skajshme ligjin për përdorimin e gjuhëve zyrtare për faktin se 90 për qind e dokumenteve të kësaj gjykate nuk është përkthyer në gjuhën shqipe. Madje edhe arsyetimi për konfirmimin e aktakuzës kundër të arrestuarit Salih Mustafa (afërsisht 66 faqe) është dorëzuar në gjuhën angleze, si të akuzuarit ashtu edhe avokatit të tij. Sipas ligjit të zbatueshëm në Kosovë për përdorimin e gjuhëve zyrtare, çdo material i gjykatës duhet të jetë në gjuhën shqipe, serbe, në gjuhën e pakicave që i plotësojnë kushtet dhe pastaj të përkthehet në gjuhën angleze. Edhe në këtë rast ku kemi të bëjmë me shkelje të rëndë të të drejtave të njeriut të personave të privuar nga liria, i ashtuquajturit Avokat i Popullit i kësaj gjykate ka reaguar me gjuhën e peshkut, duke heshtur dhe duke mos reaguar fare ndaj kësaj shkeljeje të drejtave të njeriut. KMDLNj mendon se Kuvendi i Kosovës duhet të mbledhet në një seancë ku do të diskutoheshin për këto shkelje të drejtave të njeriut të personave të privuar nga liria, shtetas të Kosovës, si themelues i kësaj gjykate dhe në përputhje me këtë të marrë vendime të duhura ose duhet ta pranojë haptas se nuk ka asnjë juridiksion mbi këtë gjykatë e që nuk e ka bërë deri më tani.



Sanohen deformimet në rrugën N2, Prishtinë - QMI

PRISHTINË, 27 TETOR (ER) - Në kuadër të mirëmbajtjes së rrugëve që janë në përgjegjësi të Ministrisë së Infrastrukturës, po bëhet edhe sanimi i deformimeve në rrugën

nacionale N2, përkatësisht nga kryeqyteti deri te QMI-ja. "Në veçanti po punohet në të tria rrethrotullimet që gjenden në këtë aks rrugor. Pjesët e dëmtuara janë gërryer dhe po

mbushen me asfalt të ri. Gjatë zhvillimit të punimeve, rruga është shenjëzuar, me qëllim të mosndaljes së qarkullimit të komunikacionit", ka njoftuar Ministria e Infrastrukturës.





PËR ÇFARË FLASIM KUR FLASIM PËR DASHURINË

Nga: Raymond CARVER
Përktheu: Agron SHALA

Ishte duke folur miku im Mell MekGinis. Mell MekGinis është kardiolog dhe kjo ndonjëherë atij i jep përparësi.

Që të katërt ishim të ulur rreth tavolinës së kuzhinës së tij. Po pinim xhin. Përmes dritares së madhe, mbrapa lavamanit, drita e diellit e zdriste kuzhinën. Aty ishim Mell, unë dhe gruaja e tij e dytë Tereza – Teri, siç e quanim ne – dhe gruaja ime Laura. Atëbotë jetonim në Albëkerki. Por, që të gjithë vinim nga vende të tjera.

Një kovë me akuj ishte mbi tavolinë. Xhini dhe uji me gaz silleshin përreth dhe ne disi u futëm në temën e dashurisë. Mell mendonte se dashuria e vërtetë s'është gjë tjetër pos dashuri shpirtërore. Na tregoi se i kishte kaluar pesë vjet të jetës së tij në një seminar për t'u bërë prift para se ta braktiste atë për Fakultetin e Mjekësisë. U shpreh se vitet e kaluara në atë seminar edhe sot i kujton si vitet më të rëndësishme të jetës.

Teri tha se burri me të cilin jetonte para se të bashkohej me Mellin e donte aq shumë sa që u përpoq ta vriste. Atëherë Teri tha: "Më rrahu një natë. Për kyçet e këmbëve më tërhiqte zvarrë nëpër dhomën e

ndenjes. Tërë kohën thoshte: "Të dua, të dua, kurvë". Nga kyçet vazhdoi të më zvarriste nëpër dhomën e ndenjes. Koka ime prapë godiste gjësendet". Teri shikoi përreth tavolinës. "Çfarë thoni për një dashuri si kjo?"

Ishte grua asht e lëkur, me fytyrë të bukur, sy të errët dhe flokë kafe që i vareshin për shpine. I pëlqenin gjerdanet e bërë nga bruza dhe vathët e gjatë pedantë.

"Pash Zotin, mos u bëjë budallaqel! Kjo s'është dashuri dhe ti fortë mirë e di këtë" – tha Mell. "Nuk e di se si do ta quash, por jam i sigurt se nuk do ta quash dashuri".

"Thuaj çfarë të duash, por unë e di se ishte" – tha Teri. "Mund të tingëllojë gjë e çmendur për ty por, po ashtu, është e vërtetë. Mell, njerëzit janë të ndryshëm. Natyrisht, ndonjëherë vepronte si i çmendur. Në rregull. Por, më donte. Ndoshta në mënyrën e tij, por më donte. Kishte dashuri aty, Mell. Mos thuaj se nuk kishte".

Melli e lëshoi një ofshamë. E mbante gotën e tij dhe u kthye kah Laura e unë. "Tipi kërcënoi të më vriste" tha Mell. E mbaroi pijen dhe e kapi shishen e xhinit. "Teri është romantike. Teri është nga shkolla 'Më-rrih-që-ta-di-se-më-do'. E dashura Teri, mos më shiko në atë mënyrë". Mell zgjatet në tavolinë dhe e prek faqen e Terit. I buzëqesh asaj.

"Tash do që të pajtohem" – thotë

Teri.

"Të pajtohem për çka?" – pyet Mell. "Çfarë ka për t'u pajtuar? Di çka di. Kjo është e tëra".

"Sidoqoftë, si ia nisëm kësaj teme?" – tha Teri. E ngriti gotën dhe piu nga ajo. "Melli e ka përherë dashurinë në mendje" – tha ajo, "apo jo i dashur"? Buzëqeshi dhe mendova se kaq i mjaftonte atij.

"Thjesht, sjelljen e Edit nuk do ta quaja dashuri. Kjo është e tëra që po them e dashur" – tha Mell. "Po për ju njerëz?" – na pyeti Mell, Laurën dhe mua: "A tingëllon për ju kjo si dashuri?"

"Unë jam personi i gabuar për t'u pyetur" – i thashë. "Unë as që e njihja tipin. Veç e kam dëgjuar emrin e tij teksa përmendet kalimthi. Nuk mund ta di. Ju duhet t'i dini detajet. Por, mendoj se ajo që je duke thënë është se dashuria është absolute".

Melli tha: "Soji i dashurisë për të cilën po flas. Për sojin e dashurisë për të cilën po flas, nuk tentoni t'i vrisni njerëzit".

Laura tha: "Nuk di gjë për Edin dhe asgjë rreth situatës. Por, kush mund ta gjykojë gjendjen e dikujt tjetër?"

Preka pjesën e pasme të shuplakës së Laurës. Ma dha një buzëqeshje të shpejtë. E mbërtheva dorën e Laurës. Ishte e ngruhtë, me thonjtë e lëmuar të bërë manikyer në mënyrë të përkryer. Me gishtërinj i bija përqark kyçit të dorës dhe e

mbaja.

"Kur e braktisa, e piu helmin e miut" – tha Teri. I kryqëzoi gishtat e dorës. "E çuan në spital në Santa Fe. Atje kemi jetuar atëherë, rreth dhjetë milje larg. Ia shpëtuan jetën. Por, mishrat e dhëmbëve iu prishën. Pra, u tërhoqën nga dhëmbët. Pas kësaj, dhëmbët i dilnin si të ujku. Oh Zot!" – tha Teri. Priti një minutë, pastaj i liroi duart dhe e kapi gotën e saj.

"Çfarë nuk janë në gjendje njerëzit të bëjnë" – tha Laura.

"Tash është pasiv" – tha Mell. "Ka vdekur".

Melli ma afroi enën me limon. Mora një copë, e shtrydha mbi pijen time dhe i trazoja kubat e akullit me gisht.

"Puna u bë më keq" – tha Teri. "E qëlloni veten në gojë. Por, edhe këtë e bëri shkel e shko. I gjori Edi" – tha ajo. Teri tundi kokën.

"Jo i gjori Edi" – tha Mell. "Ishte i rrezikshëm".

Melli është 45 vjeç. I gjatë dhe shtathedhur e me flokë të buta kaçurrela. Fytyra dhe duart ishin ngjyrë kafe nga tenisi që luante. Kur ishte i kthjellët, gjestet e tij, të gjitha lëvizjet e tij, ishin precize e shumë të kujdesshme.

"Mell, ai, megjithatë, më donte. Pranoje këtë" – tha Teri. "Kjo është gjithçka që po ta kërkoj. Ai nuk më donte ashtu si më do ti. Nuk po e them këtë. Por, më donte. Ti mund ta pranosh këtë, apo jo?"

"Çka mendon kur the, e bëri shkel e shko?" – e pyeta.

Laura u përku para me gotën e saj. I vendosi bërrylat në tavolinë dhe e mbante gotën me të dyja duart. Shikoi kah Mell e Teri dhe priste me një vështrim të hutuar në fytyrën e saj të sinqertë, sikur mahnitej me faktin se gjërat e tilla u ndodhnin njerëzve me të cilët jemi miq.

"Si e bëri shkel e shko kur e vrau veten?" – pyeta.

"Do t'ju tregoj se çfarë ndodhi" – tha Mell. "E ka marrë revolen 22-she, të cilën e bleu për të na kërcënuar, Terin dhe mua. Ej, jam serioz, tipi gjithmonë kërcënonte. Duhet ta kishit parë se si kemi jetuar ato ditë. Si të arratisur. Edhe unë për veten time e bleva një armë. A mund ta besosh? Një njeri si unë? Por, e bëra. E bleva revolen për vetëmbrojtje dhe e mbaja në syzën e përparme të veturës. Ndonjëherë, në pik të natës më duhej të largohesha nga banesa. E dini pra, për të shkuar në spital? Teri dhe unë atëherë s'ishim të martuar. Gruaja ime e parë e kishte shtëpinë me fëmijët, qenin, gjithçka, ndërsa Teri dhe unë jetonim këtu, në këtë banesë. Ndonjëherë, siç isha duke thënë, e merrja një telefonatë në mes të natës, ndaj më duhej të shkoja në spital në dy ose tre të mëngjesit. Ishte errët atje në parking, ndaj bëhesha djersë para se të futesha

në makinën time. Asnjëherë s'e dija nëse do të dilte nga shkurnajat apo nga prapa makinës, për të filluar me të shtënat. Dua ta them se tipi ishte i çmendur. Ishte i aftë ta montonte një bombë, gjithçka. Thërriste ndërrimin gjatë gjithë kohës dhe shprehej se i duhej të fliste me mjekun, e kur përgjigjesha më thoshte: "Bir kudre, ditët tua janë të numëruara". Gjëra të tilla si kjo. Pra, jua them ishte gjë e frikshme".

"Unë ende ndiej keqardhje për të" – tha Teri.

"Tingëllon si makth" – tha Laura. "Por, çfarë ndodhi saktësisht pasi e qëlloi veterin?"

Laura është ndihmësavokate. Jemi takuar në baza profesionale. Shumë shpejt lindi romanca. Ajo është 35 vjeçe, tri vjet më e re se unë. Përveç faktit se jemi të dashuruar, e pëlqejmë njëri-tjetrin dhe e shijojmë shoqërinë e njëri-tjetrit. Ajo është shumë e përshtatshme për lidhje.

"Çka ndodhi?" – tha Laura.

Melli tha: "E qëlloi veten në gojë, në dhomën e tij. Dikush e dëgjo të shtënat dhe i tregoi mbikëqyrësit të ndërtesës. Shkuan me çelës kopil, panë se çfarë kishte ndodhur dhe e thirrën ambulancën. Rastisi të jem aty kur e sollën – të gjallë, por pa vetëdije. Tipi jetoi edhe tri ditë. Koka e tij u bymye në dyfishin e madhësisë së një koke normale. Kurrë nuk kisha parë diçka të tillë dhe shpresoj se nuk do ta shoh kurrë më. Kur e kuptoi se çfarë kishte ndodhur, Teri donte të hynte dhe të ulej pranë tij. U përllamë për këtë. Mendoj se nuk duhej ta shihnte ashtu. Mendoj se fare nuk do të duhej ta shihnte dhe këtë e mendoj edhe sot".

"Kush e fitoi përlëshjen?" – tha Laura.

"Isha në dhomë me të kur vdiq" – tha Teri. "Kurrë nuk u pajtua me këtë. Por, unë u ula pranë tij. Nuk e kishte askënd tjetër".

"Ai ishte i rrezikshëm" – tha Melli. "Nëse e quan këtë dashuri, mbaje për vete pra".

"Ishte dashuri" – tha Teri. "Natyrisht, është abnormale në sytë e shumë njerëzve. Por, ishte i gatshëm të vdiste për të. Ai vdiq për të".

"Unë natyrisht se nuk do ta quaj kurrë dashuri" – tha Melli. "Dua të them se askush s'e di se për çfarë e bëri. Kam parë shumë vetëvrasje dhe nuk mund të them se dikush e di se për çfarë e kishin bërë".

Melli i vuri duart pas qafës dhe e anoi karrigen mbrapa. "Nuk jam i interesuar për atë lloj dashurie" – tha ai. "Nëse kjo është dashuri, mbajeni për vete".

Teri tha: "Kishim frikë. Melli madje e bëri një testament dhe i shkroi vëllait të tij në Kaliforni që dikur ishte pjesëtar i forcave speciale. Melli i tregoi se me çfarë duhej të merrej nëse do t'i ndodhte diçka". Teri piu nga gota e saj. Tha: "Por, Melli ka të drejtë – jetuam si të arratisur. Kishim frikë. Melli ishte i frikësuar, apo jo i dashur? Unë në një rast madje e thirra policinë, por nuk na ndihmoi. Tha se nuk mund të bëjë asgjë derisa Edi nuk

ndërmerr diçka. A nuk është për të qeshur?" – pyeti Teri.

Ajo e derdhi pjesën e fundit të xhinin në gotën e saj dhe e tundi shishen. Melli u ngrit nga tavolina dhe shkoi te dollapi e mori një shishe tjetër.

"Epo, Niku dhe unë e dimë se çfarë është dashuria" – tha Laura. "Dua të them, për ne" – tha Laura. E përplasi gjurin tim me gjurin e saj. "Besoj se tash ti duhet të thuash diçka" – tha Laura dhe e ktheu buzëqeshjen tek unë.

Si përgjigje, e kapa dorën e Laurës dhe e ngrita te buzët e mia. E bëra një shfaqje të madhe duke e puthur dorën e saj. Të gjithë u argëtuuan.

"Jemi me fat" – thashë.

"Ej, njerëz" – tha Teri. "Ndaleni atë. Po më çmendni. Pashë Zotin, ende jeni në muajin e mjaltit? Ende jeni të eksituar, djalli ta haj. Pritni pak. Qe sa kohë jeni bashkë? Qe sa kohë? Një vit? Më shumë se një vit?"

"Po shkojmë te një vit e gjysmë" – tha Laura, e skuqur dhe buzëqeshur.

"Eh, tash" – tha Teri. "Pritni edhe pak".

E mbante pijen dhe e shikonte Laurën.

"Po bëj shaka" – tha Teri.

Melli e hapi xhinin dhe me shishe u soll rreth tavolinës.

"E pra, njerëz" – tha ai. "Ta ngremë një doli. Dua ta propozoj një doli. Një doli për dashurinë. Për dashurinë e vërtetë" – tha Melli.

I cakëruam gotat.

"Për dashurinë!" – thamë.

Jashtë, në oborrin e shtëpisë, një prej qenve nisi të lehtë. Gjethet e plepit që përkuleshin në dritare e preknin xhamin. Dielli i pasdites ishte si prania në dhomë – një dritë e bollshme e çlodhjes dhe e bujarisë. Mund të ishim kudo, diku të magjepsur. I ngritëm gotat sërisht dhe i buzëqeshëm njëri-tjetrit sikur fëmijët që merren vesh për diçka të ndaluar.

"Jua them unë se çka është dashuria e vërtetë" – tha Melli.

"Mendoj se do t'jua jap një shembull të mirë. Dhe pastaj ju mund t'i nxirrni përfundimet tuaja" shtoi. Dërdhi më shumë xhin në gotën e vet. Ia shtoi një kub akull dhe një copë limon. Prsnim dhe e pimë nga një gllënjë. Unë dhe Laura i prekëm gjunjët përsëri. E futa dorën në kofshën e saj të ngrohtë dhe e lashë aty.

"Çfarë di secili nga ne për dashurinë?" – pyeti Melli. "Më duket se jemi fillestarë në dashuri. Themi se e duam njëri-tjetrin dhe, e duam, nuk kam dyshim për këtë. Unë e dua Terin dhe Teri më do. Edhe ju njerëz e doni gjithashtu njëri-tjetrin. E dini sojin e dashurisë për të cilën tash po flas? Dashurinë fizike, atë impuls që ju shtyn te dikush i veçantë, si dhe dashurinë ndaj qenies së personit tjetër, esencës së tij ose të saj, në çfarëdo mënyre. Dashurinë sensuale dhe, po pra, ta quajmë dashuri sentimentale, me kujdesin ditor për personin tjetër. Por, ndonjëherë e kam të vështirë ta marrë parasysh faktin se, po ashtu, mund ta kem

dashur edhe gruan time të parë. Por, e kam dashur. E di se po. Besoj se në këtë aspekt jam si Teri. Si Teri dhe Edi". Mendoi pak për këtë dhe vazhdoi. "Ka momente kur mendoj se më shumë se veten time e kam dashur gruan time të parë. Por, tash e urrej guximën e saj. E urrej. Si e shpjegoni këtë? Çfarë ndodhi me atë dashuri? Çfarë ndodhi me të është ajo që dua ta di. Dua dikush të ma thotë. Pastaj është Edi. Në rregull, iu rikthyem Edit. Ai e donte Terin aq shumë sa që tentoi ta vriste atë dhe përfundoi duke e vranë veten". Melli u ndal së foluri, për të pirë nga gota e tij. "Ju njerëz jeni bashkë qe tetëmbëdhjetë muaj dhe e doni njëri-tjetrin. Shihet ashiqare kjo. Po shkëlqeni. Por, ju të dy i keni dashur njerëzit e tjerë përpara se të takoheshit me njëri-tjetrin. Ju të dy ishit të martuar më parë ashtu si ne. Dhe, po ashtu, ju mbase keni dashur njerëz të tjerë edhe para kësaj. Teri dhe unë jemi bashkë qe pesë vjet, e jemi martuar qe katër. Dhe, gjëja e tmerrshme, gjëja më e tmerrshme dhe gjëja e mirë – shëlbesë mund ta quani – është se nëse diçka do t'i ndodhte njërit prej nesh – më falni që e them këtë – nëse diçka do t'i ndodhte nesër njërit prej nesh, mendoj se tjetri, e dini pra se personi tjetër do të mërzhitej për një kohë, por atëherë pala e mbijetuar do të jetojë dhe do të dashurojë përsëri e do ta ketë shpejt dikë tjetër. E gjithë kjo, e gjithë kjo dashuri për të cilën po flasim, do të ishte thjesht një kujtim. Ndoshta as kujtim! A e kam gabim? A po keqkuptohem? Dua të më korrjoni nëse mendoni se e kam gabim. Dua ta di. Dua të them se nuk di asgjë dhe se jam i pari që po e pranoj".

"Pashë Zotin, Mell" – tha Teri. U

zgjat dhe e kapi kyçin e dorës së tij. "Mos po dehesh? Zemër? A je dehur?"

"E dashur, unë po flas" – tha Melli. "Në rregull? Nuk kam nevojë të dehem për ta thënë atë që mendoj. Pra, jemi duke biseduar, apo jo?" – pyeti Melli dhe ia fiksoi shikimin asaj.

"I dashur, nuk po të kritikoj" – tha Teri. E kapi gotën e saj.

"Sot nuk jam kujdestar" – tha Melli. "Më lejoni t'jua kujtoj këtë. Nuk jam kujdestar" – tha ai.

"Mell, ne të duam" – tha Laura.

Melli e shikoi Laurën. E shikoi thuajse nuk kishte çfarë të bënte, sikur nuk ishte gruaja që ishte. "Të dua, po ashtu, Laura" – tha Melli. "Edhe ty Nik të dua, po ashtu. A dini diçka?" – tha Melli. "Ju jeni dostat tanë" – tha Melli. E kapi gotën e tij.

Melli tha: "Doja t'ju tregoja diçka. Pra, u mundova ta dëshmoja një gjë. E shihni, kjo ka ndodhur disa muaj më parë, por po vazhdon edhe tash dhe duhet të na bëjë të ndihemi të turpëruar kur flasim kinse po dimë se për çfarë po flasim kur flasim për dashurinë".

"Mjaft tani" – tha Teri. "Mos fol sikur je i dehur, nëse nuk je i dehur".

"Mbylle gojën të paktën këtë herë" – tha Melli, qetë. "A ma bën këtë nder për një minutë? Pra, siç isha duke thënë, ishte një çift i vjetër që kishte një veturë që u shkatërrua në magjistrale. Një fëmijë i goditi ata dhe të gjithë u bënë copë e askush nuk besonte se mund t'ia dilnin mbanë".

Teri shikoi kah ne e pastaj Mellin. Dukej e nervozuar apo, ndoshta, kjo është fjalë shumë e rëndë. Melli e shërbente shishen rreth tavolinës.

"Isha kujdestar atë natë" – tha

Melli. "Ishte maji ose, mbase, ishte qershori. Teri dhe unë sapo ishim ulur për darkë kur më thirrën nga spitali. Ka ndodhur kjo gjë në magjistrale. Një fëmijë i dehur, tujxher, i ra me kamionçinën e babait kamperit me këtë çiftin e vjetër brenda. Ky çift ishte në mes të shtatëdhjetave. Fëmija – 18 apo 19 vjeç, ashtu diçka – i vdekur në vend. Timoni kishte depërtuar kafazin e kraharorit të tij. E kuptuat, çifti i vjetër ishte gjallë. Desha të them, mezi të gjallë. Por, kishin gjithçka – fraktura të shumta, lëndime të brendshme, hemorragji, shembje, çarje dhe secili prej tyre i kishte tronditjet e veta. Më besoni, ishin keq. Dhe, sigurisht se mosha ishte goditje e dyfishtë për ta. Mendoj se ajo ishte më keq se ai. Shpretkën e çarë me gjithçka tjetër. Të dy gjunjët e thyer. Por, ata i kishin vënë rripat e sigurimit dhe, Zoti e di, kjo ishte ajo që i shpëtoi". "Njerëz, kjo është reklamë për Këshillin e Sigurisë Kombëtare" – tha Teri. "Po flet zëdhënësi juaj, dr. Mellvin R. MekGinis" – qeshi Teri. "Mell" – tha ajo, "ndonjëherë e tepron. Por, të dua zemër" – tha ajo. "E dashur, të dua" – tha Melli.


Ai u zgjatë në gjysmë të tavolinës. Teri e takoi në mes. U puthën.

"Teri ka të drejtë" – tha Melli teksa ulej. "Lidhini ata rripa të sigurisë. Por, seriozisht, ata të moshuar ishin në njëfarë forme. Në kohën kur arrita, siç e thashë, fëmija kishte vdekur. Ai ishte jashtë në një qoshe, i shtrirë në një shtrat me rrota. E kontrollova çiftin e vjetër dhe i thashë infermierit që ta dërgonte menjëherë një neurolog, një ortoped dhe disa kirurgë".

Piu nga gota e tij. "Po përipiqem t'i bie shkurt" – tha. "Kështu që, i futëm të dy në sallën e operacionit dhe punuam si të mallkuar shumicën e natës. Ata të dy kishin rezervë të jashtëzakonshme. E shihni këtë një herë për një kohë të gjatë. Kështu që bëmë gjithçka që mund të bëhej dhe në mëngjes parashikuam për ta një shans pesëdhjetë me pesëdhjetë, ndoshta më pak se kaq për gruan. Pra, ja ku janë, të gjallë mëngjesin tjetër. Në rregull, i zhvendosëm në kujdesin intensiv dhe të dy, për dy javë, ishin të lidhur për aparate, duke u bërë më mirë në të gjitha fushat. Ndaj, i transferuam në dhomat e tyre". Melli pushoi së foluri. "Tash" – tha ai, "ta pimë me fund këtë xhin të lirë. Atëherë do të shkojmë për darkë, apo jo? Teri dhe unë e dimë një lokal të ri. Atje do të shkojmë, tek ai lokal i ri që e dimë. Por, nuk do të shkojmë derisa ta përfundojmë këtë xhin të lirë e të keq".

Teri tha: "Në fakt, ende nuk kemi ngrënë atje. Por, duket mirë. E dini pra, nga jashtë".

"Më pëlqen ushqimi" – tha Melli. "Nëse do ta nisja jetën sërisht, a e dini se më me qejf do të bëhesha kuzhinier? Apo jo Teri?" – pyeti Melli. Ai qeshi. E lëvizi me gisht akullin në gotë. "Teri e di" – tha ai. "Teri mund t'jua thotë. Por, më lini ta them këtë. Nëse do të mund ta nisja sërisht një jetë tjetër, në një kohë dhe gjithçka tjetër, e dini çka?"




Do të doja të kthehesha si kalorës. Ishe goxha i sigurt i veshur me gjithë atë mburojë hekuri. Ishte mirë të ishe kalorës derisa nuk erdhën baruti, musketat dhe revolet". "Melli do të donte të kalëronte dhe ta mbante ushtën" – tha Teri. "Ose një femër" – tha Melli. "Turp të kesh" – tha Laura. "Bujkrobërit kurrë nuk e kishin mirë" – tha Melli. "Por, mendoj se edhe kalorësit ishin veselë të dikujt. A nuk ishte kjo mënyra se si shkonin gjërat? Atëherë të gjithë ishin veselë të dikujt. Apo jo? Teri? Por, pos zonjave të tyre, ajo që më pëlqen te kalorësit është se e kishin atë mburojë të hekurt pra, dhe nuk mund të lëndoheshin lehtë. Asnjë veturë në atë kohë, e kuptoni? Asnjë tinxher i dehur për t'ju mësyre e copëtuar". "Vasalë" – tha Teri. "Quheshin vasalë, jo veselë". "Vasalë, veselë" – tha Melli, "ku është dallimi? E dije se çfarë doja të thosha. Në rregull" – tha Melli. "Pra, nuk jam i shkolluar. I kam mësuar gjërat e mia. Natyrisht, jam kirurg i zemrës. Por, thjesht, jam mekanik. Futem, sillem e pështillem dhe rregulloj gjëra. Djalli ta hajë!" – tha Melli. "Modestia nuk të shkon" – tha Teri. "Është thjesht një kirurg i përlurur" – thashë. "Por, Mell, nganjëherë ata ngufateshin në gjithë atë mburojë hekuri. Ata kishin madje sulme zemre nëse bëhej shumë nxehtë dhe ishin të lodhur e të rraskapitur. Kam lexuar diku se binin nga kuajt dhe se nuk mund të ngriheshin meqë ishin shumë të lodhur për t'u çuar me gjithë atë mburojë në trup. Ndonjëherë u shkelën nga kuajt e tyre". "Kjo është e tmerrshme" – tha Melli. "Është e tmerrshme Nik. Them se rrinin të shtrirë dhe prinin derisa të vinte dikush për të bërë qebapë nga ta".

"Ndonjë veselë tjetër" – tha Teri. "Po pra" – tha Melli. "Ndonjë vasal do të vinte dhe do ta shponte bastardin me shtizë, në emër të dashurisë. Ose për çfarëdo tjetër që luftonin atë kohë". "Për të njëjtat gjëra që luftojmë në sotmen" – tha Teri. Laura tha: "Asgjë nuk ka ndryshuar". Ngjyra ishte akoma e ndeztë në faqet e Laurës. Sytë e saj ishin të ndritshëm. E afroji gotën te buzët e saj. Melli ia qiti vetes edhe një pije. Shikoi nga afër etiketën, sikur po studioje një rresht të gjatë numrash. Pastaj e vendosi ngadalë shishen poshtë në tavolinë dhe ngadalë e kapi ujin e gazuar. "Po çfarë ndodhi me çiftin e vjetër?" – pyeti Laura. "Nuk e përfundove tregimin që e nise". Laura kishte probleme për ta ndezur cigaren. Shkrepsët e saj vazhdimisht fikeshin. Drita e Diellit brenda dhomës tash ishte ndryshe – duke u ndryshuar, duke u bërë më e dobët. Por, gjetet jashtë dritares ende valëviteshin, e unë e shikoja modelin që kishin bërë në dritare dhe në banakun e drunjatë. Natyrisht, nuk ishin të njëjtat modele. "Çka ndodhi me çiftin e vjetër?" – pyeta. "Të vjetër, por më të zgjuar" – tha Teri. Melli ia nguli sytë. Teri tha: "Vazhdo zemër tregimin tënd. Bëra shaka. Çfarë ndodhi pastaj?" "Ndonjëherë Teri" – tha Melli. "Të lutem Mell" – tha Teri. "I dashur, mos u bëj përherë kaq serioz. A nuk mund ta pranosh një shaka?" E mbante gotën dhe e shikonte pa nda gruan e tij. "Çka ndodhi?" – tha Laura. Melli e zhvendosi shikimin kah

Laura. Ai tha: "Laura, po mos ta kisha Terin e po mos ta doja kaq shumë, dhe po të mos ishte Niku shoku im më i mirë, do të dashurohesha në ty e do të të vidhja zemër", tha ai. "Vazhdoje rrëfimin" – tha Teri. "Atëherë do të shkojmë tek ai lokali i ri, në rregull?" "Mirë" – tha Melli. "Ku mbeta?" – tha ai. Shikoi tavolinën dhe ia nisi sërish. "Çdo ditë ndalesha ta shihja secilin prej tyre, ndonjëherë dy herë në ditë nëse bëja kontrolle të tjera. Me gips dhe fasha që të dy, që nga koka e deri te këmbët. E dini, e keni parë këtë nëpër filma. Kështu dukeshin ata, si në filma. Vrima të vogla për sy, për hundë dhe për gojë. Dhe, asaj i duhej t'i mbante këmbët varur. Epo, burri ishte më i dëshpëruar. Edhe kur e kuptoi se gruaja e tij do t'ia dilte mbanë, ai vazhonte të ishte i dëshpëruar. Por, jo për aksidentin. Dua të them që aksidenti ishte një gjë, por nuk ishte gjithçka. E dini çka, afrohesha te vrima e gojës së tij dhe ai do të thoshte se jo, se nuk ishte fjala për aksidentin, por sepse nuk mund ta shihte atë përmes vrimave për sy. Ai tha se kjo ishte ajo që po e bënte të ndihej kaq keq. A mund ta paramendosh? Unë po jua them, zemra e burrit thyhej sepse ai nuk mund ta kthente atë drejt koke dhe ta shihte atë drejt gruaje". Melli shikoi rreth tavolinës dhe tundi kokën për atë që do të thoshte. "Dua të them se kjo po e vriste atë plak, veç pse nuk mund ta shihte atë drejt gruaje". Të gjithë e shikuan Mellin. "A e kuptoni atë që po e them?" – tha ai. Ndoshta atëherë ishim pak të dehur. E di se ishte e vështirë ta ruaje përqendrimin te këto gjëra. Drita po ikte nga dhoma, duke u kthyer nëpër dritaren nga ku u fut.

Megjithatë, askush nuk e bëri asnjë lëvizje për t'u ngritur nga tavolina e për ta ndezur dritën mbi kokat tona". "Dëgjo" – tha Melli. "Ta përfundojmë këtë xhin të keq. Ka mbetur mjaft sa edhe për nga një gotë, për secilin. Pastaj do të dalim të hamë. Do të shkojmë tek ai lokali i ri". "Ai është në depresion" – tha Teri. "Mell, pse nuk e merr pilulën?" Melli tundi kokën. "I kam pirë të gjithat që ishin". "Dikur të gjithë do të kemi nevojë për pilula" – thashë. "Disa njerëz lindin për të pasur nevojë për to" – tha Teri. Ajo e përdorte gishtin për të fshirë diçka në tavolinë. Pastaj ndaloi së fërkuari. "Them se dua t'i thërras fëmijët" – tha Melli. "A keni diçka kundër ju? Do t'i thërras fëmijët e mi". Teri tha: "Po sikur Marxhoria të lajmërohet në telefon? Njerëz, ju na keni dëgjuar teksa flisnim për temën Marxhori? I dashur, ti e di që nuk ke qejf të bisedosh me Marxhorinë. Do të të bënte të ndiheshe edhe më keq". "Nuk dua të flas me Marxhorinë" – tha Melli, "por dua të flas me fëmijët e mi". "Nuk kalon një ditë që Melli të mos thotë se sa do që ajo sërish të marthohet. Ose të vdes" – thotë Teri. "Por, një gjë dihet" – thotë Teri, "ajo po na falimenton. Melli thotë se për inat të tij ajo nuk do të marthohet sërish. E ka një të dashur me të cilin jeton, bashkë me fëmijët, kështu që Melli po e mbështet edhe të dashurin e saj". "Ajo është alergjike në bletë" – thotë Melli. "Nëse nuk lutem që të marthohet sërish, lutem që të thumbohet për vdekje nga një luzmë e bletëve të mallkuara". "Turp të kesh" – tha Laura. "Bzzz..." – tha Melli, duke i kthyer gishtat në bletë dhe duke gumëzhi-

tur nëpër fytin e Terit. Pastaj i tërhoqi duart tek ana e tij. "Ajo është e mbrapshtë" – tha Melli. "Ndonjëherë mendoj të shkoj atje, i veshur si bletar. E dini si, me atë kapelë që është si helmetë me rrjetën që zbrret poshtë fytyrës, me dorëzat e mëdha dhe mbulesën e gjatë? Do të trokisja në derë dhe do të lëshoja një koshere bletësh në shtëpi. Por, natyrisht, së pari do të sigurohesha që fëmijët janë jashtë". E vuri njëren këmbë mbi tjetren. Duke se i duhej kohë për ta bërë këtë. Pastaj i vuri të dyja këmbët në dysheme dhe u përkul përpara, me bërnylat mbi tavolinë e mjekrën e tij të mbërthyer nga duart. "Mbase nuk do t'i telefonoj fëmijët. Ndoshta nuk është ide aq e mirë. Ndoshta, thjesht, do të shkojmë të hamë. Si ju duket kjo?" "Më duket mirë" – thashë. "Të hamë apo të mos hamë. Apo të vazhdojmë të pimë. Mund të duroj deri në muzg". "Çfarë do të thotë kjo, i dashur?" – pyeti Laura. "Do të thotë ajo që thashë" – i thashë. "Do të thotë se mund të vazhdoj. Kjo është e tëra që e mendova". "Unë do të haja diçka" – tha Laura. "Nuk besoj se ndonjëherë në jetë kam qenë më e uritur se tash. A ka diçka për të grimtuar". "Do të vë ca djathë dhe biskota të njelmëta" – tha Teri. Por, Teri rrinte ulur. Nuk u çua për të marrë asgjë. "Melli e ktheu gotën e tij. E derdhi në tavolinë". "Xhini mbaroi" – tha Melli. Teri tha: "E çka tash?" Mund ta dëgjoja zemrën duke rrahur. Mund ta dëgjoja zemrën e secilit. Mund ta dëgjoja zhurmën njerëzore që e bënim kur askush nuk po lëvizte, madje edhe kur dhoma nisi të errësohej. /Revista "Akademia"



AGK publikon hulumtimin “Ndikimi i Pandemisë COVID 19 në gjendjen ekonomike të gazetarëve, kameramanëve dhe fotoreporterëve”

Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK) me mbështetje të Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS), sot publikoi hulumtimin “Ndikimi i Pandemisë Covid-19 në gjendjen ekonomike të gazetarëve, kameramanëve dhe fotoreporterëve”.

Hulumtimi është realizuar nga hulumtuesja Lirika Demiri dhe fokusohet në largimet nga puna dhe zvogëlimi i pagave të gazetarëve, ndikimin e Pakos Emergjente në sektorin e medieeve, si dhe mirëqenien fizike e mendore të punëtorëve medialë gjatë periudhës së pandemisë COVID 19.

Drejtoresha Ekzekutive e Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës, Getoarë Mulliqi Bojaj, shprehu falënderimin në emër të AGK-së për pjesëmarrjen e panelistëve, medieeve, si dhe për përkrahjen e dhënë nga KFOS-i gjatë kohës së pandemisë, gjë që ka qenë shumë e rëndësishme për komunitetin e gazetarëve, fillimisht në sigurimin e mjeteve mbrojtëse e më pastaj edhe me përkrahjen e këtij hulumtimi, i cili vë në pah gjendjen e gazetarëve, kameramanëve dhe

fotoreporterëve në kohë të pandemisë.

“Ky raport ka për qëllim të shpalosë gjendjen ekonomike apo ndikimin të cilin e ka pasur pandemia Covid 19 në gjendjen ekonomike të gazetarëve, kameramanëve dhe fotoreporterëve. Me KFOS-in ka qenë bashkëpunimi i parë fare në fillim të pandemisë kur kemi kërkuar ndihmë nga ta që të sigurojnë mjete mbrojtëse për anëtarët tanë, gjegjësisht gazetarët, kameramanët dhe fotoreporterët, të cilët kanë qenë në vijën e parë të frontit duke u përballur me një të panjohur”, tha Mulliqi Bojaj.

Ndërsa, hulumtuesja e raportit, Lirika Demiri, shpalosi para të pranishmëve të gjeturat e raportit.

“Raporti është rezultat i një hulumtimi që është zhvilluar prej



muajit qershor të këtij viti deri në fund të muajit shtator. Kemi realizuar një anketë online me rreth 120 punonjës medialë – gazetarë, kameramanë dhe fotoreporterë, dhe kemi marrë përgjigjet e tyre që kanë të bëjnë kryesisht me ndikimin e pandemisë në gjendjen ekonomike të punonjësve medialë, si dhe me ndryshimin e dinamikës dhe vështirësitë e hasura gjatë raportimit në pandemi. Përveç anketës, ne kemi zhvilluar edhe intervista me

gazetarë të ndryshëm dhe me profesionistë të fushës së medias”, ka thënë Demiri.

Pjesë e panelit të diskutimit ishin edhe gazetarët Jehona Zhitia dhe Bujar Vitija.

Gazetarja Zhitia tregoi disa nga sfidat me të cilat janë përballur gazetarët gjatë raportimit për pandeminë Covid 19.

“E kemi nisur këtë sfidë pa ditur se çfarë na pret gjatë rrugës. Pavarësisht përvojës së gjatë që mund të kesh në medie, ne jemi

më të rinj në moshë dhe nuk na ka rastisur që të raportojmë në ndonjë situatë të ngjashme shëndetësore. Ndonëse edhe vetë mjekët e kishin shumë të panjohur atë se çfarë do të ndodhë në ditët në vazhdim, kjo bëhej edhe më e vështirë ndoshta për neve si gazetarë, për formën tonë të raportimit se çfarë do të themi në fillim...Konsideroj që ishte sfidë edhe për gazetarët, megjithatë ne ia dolëm që ta bënim punën më së miri”, ka thënë ndër të tjera ajo.

Teksa, Vitija foli për rolin e medieeve dhe gazetarëve në menaxhimin e pandemisë.

“Roli i medieeve ka qenë mjaft i rëndësishëm. Gazetarët asnjëherë nuk kanë hezituar që ta kryejnë punën e tyre më përgjegjësi në luftimin e lajmeve të rrejshme. Rreth 30% e kosovarëve nuk kanë besuar në ekszitencën e Covid 19 dhe kjo e ka vështirësuar në masë të madhe menaxhimin e pandemisë nga institucionet. Rol të rëndësishëm për ta përmbysur këtë sondazh, kanë luajtur mediet dhe gazetarët”, ka thënë ndër të tjera Vitija.

Raportin e plotë në Gjuhën Shqipe dhe Gjuhën Angleze e gjeni në këtë link: <https://rb.gy/efzdso>

Jeta fillon pas moshës 40-vjeçare, është një epokë e re e vetes tuaj

Gjithmonë e kam ndjerë që jeta është më e mirë pasi bën dyzet vjeç. Unë rrëfej që kam gjetur çelësin e jetës, për të folur e për të ngushëlluar ata që po vinë drejt nesh, drejt 40-vjeçarëve.

Edhe sot, kam sigurinë absolute të kësaj të vërtete dhe pyes veten nëse do të ketë një ndryshim kaq të madh dhe pozitiv në një dekadë tjetër, si në këtë fazë të jetës sime. Jeta bëhet më e lehtë, më e thjeshtë, më e gjallë. Pra, shumë gjëra pushojnë së ekzistuari, ndërsa të tjerat pushojnë së qeni të rëndësishme.

Revolta zhduket, si dhe ndjenjat e fajit dhe çdo keqardhje. Ajo që një herë të ka lënduar apo mërzhitur thjesht pushon së qeni. Dhe shqetësimi për opinionin e të tjerëve është diçka që nuk kalon përmes mendimeve të tua.

Dhe nuk do të ishte e drejtë të thuhet se ky transformim vjen nga asgjëja. Kjo metamorfozë vjen me të gjitha gabimet e së kaluarës, shuplakat në fytyrë, zhgënjimet, frustrimet dhe madje edhe dhimbjet që transformohen në mësim falë të tjerëve.

Të shikuarit prapa ju bën të shihni shumë gabime. Për një kohë të shkurtër kjo gjithashtu mund të

jetë shkak për turp, por atëherë, sigurisht, e kuptojmë se gjëja e gabuar ka shërbyer për të na treguar saktësisht se ku jemi: në kohën e duhur.

Marrëdhëniet janë më të mira, njerëzit rreth nesh janë ata që duan të qëndrojnë, dhe ne, gjithashtu, jemi me ata që duam. Në këtë jetë asgjë nuk është rastësisht, madje edhe ata që kalojnë rrugën tonë, vetëm për një moment, kanë diçka për të na mësuar, vetëm kushtojni vëmendje.

Në të dyzetat ke ndjesinë sikur nuk ke nevojë për askënd!

Jo nga krenaria apo diçka e tillë, por mungesa e romantizmit të tepërt të vjetër na lejon t'i shohim gjërat siç janë me të vërtetë.

Miqtë bëhen një nga gjërat më të mrekullueshme që keni. Takimet me disa të mbetur pas disa dekadash dhe të gjitha prirjet dhe ndërlikimet e viteve historike së bashku. Unë besoj se kjo është një nga dhuratat më të mëdha të jetës!



Puna nuk është më barrë dhe bëhet e lehtë. Në fund kuptojmë se çdo punë me të vërtetë është dinjitoze. Çdo gjë bëhet një arsye për rritjen personale. Asgjë tjetër nuk vjen me dallgë, ashtu si kohët e mëparshme.

Lidhjet familjare bëhen shumë

më të mëdha. Shikon kohën që kalon në fytyrat e atyre që i duam më së shumti: prindërit dhe fëmijët tanë. Si na dhemb të shohim ata që na dhanë jetën duke humbur kështu gjallërinë e tyre.

Dhe sa krenar duhet të jemi tek shohim pasardhësit të rriten ashtu

si ne dikur, duke përsëritur të njëjtat gabime dhe duke zbuluar ngadalë përgjigjet e sakta, rrugën që askush nuk ta mëson: shtegun individual të secilit.

Koha më në fund mëson një perceptim të ri të jetës, në vetvete dhe prej aty ndryshon gjithçka. Pësha mbi shpatulla bëhet vullneti për të jetuar, për të shfletuar, për të mësuar të luash në jetë, për të bërë diçka që nuk e ke bërë kurrë, për të shijuar jetën, para se të përfundojë. Nuk është frika e vdekjes, është dëshira për të jetuar jetën siç nuk është bërë kurrë më parë, me perceptimin e pjekur tashmë që vetëm vitet të lejojnë ta kesh.

Rinia mund të ketë bukurinë e saj, por është plot me injorancë dhe kurrë nuk do të ketë perceptimin e dikujt në të dyzetat dhe kjo është ajo që i ngushëllon të gjithë ata që kanë frikë të plaken.

Më besoni, jeta përmirësohet shumë gjatë kohës! Edhe në qoftë se gjallëria është e humbur, njohuria e jetës kompenson çdo rrudhë në sy, varje ose kilogram shtesë. Pa marrë parasysh sa dhimbje keni përjetuar, do të vijë koha kur do të përdorni gjithçka që keni mësuar, natyrisht në favor të vetes.

/Kultplus.com/

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT
PILKINGTON ENVERI
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE

'BUJQËSIA'

TEL: 045/82 82 82

FERONIKELI RIKTHEN KRIZËN E LLAPIT

“Nikli”, pas shtatë ndeshjeve, e shijon fitoren në Superligë, kurse Llapi u është rikthyer sërish rezultateve negative. Në ndeshjen tjetër që u zhvillua të mërkurën, Drita e mposhti Arbërinë



EPOKA E RE **Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 27 TETOR - Skuadra e Feronikelit është këndellur të martën dhe ka shënuar fitore ndaj Llapit (1-0), duke e regjistruar fitoren e dytë në këtë edicion dhe të parën nën drejtimin e trajnerit Klodian Duro. Në anën tjetër skuadra nga Podujeva iu rikthehet rezultateve negative. Në pjesën e parë rastet nuk munguan për të dyja skuadrat, por gola nuk pati. Në minutën e 54-t Yll Hoxha me një gjuajtje nga largësia shënoi për 1-0. Llapi rrezikon dy herë pas një ore lojë, por Zhdrella dhe Januzi nuk arritën ta barazojnë rezultatin. Në minutën e 65-të, Mentor Zhdrella provon nga gjuajtja e lirë, por topi përfundon mbi portën e portierit vendës. Sulmuesi Ahmed Januzi e pati edhe një rast për të shënuar i cili përfundoi jashtë. Edhe Dabiqaj i vendësve pati një rast të mirë, kurse Prenqi bën një ndërhyrje fantastike. Ndeshja përfundoi me rezultat 1-0. Klubi nga Drenasi tash ka 10 pikë dhe zë vendin e nëntë në renditjen tabelore. Llapi është në pozitën e parafundit me vetëm pesë pikë. Të martën është zhvilluar edhe një

ndeshje e javës së nëntë në Superligën e Kosovës në futboll. Drita, që është kampione në fuqi, e mposhti Arbërinë me rezultat 0-1. Sulmuesi kryesor i Dritës, Kastriot Rexha, në njëzetë minutat e parë provon të shënojë dy herë por, pa sukses. Edhe Bruqi e shpërdori një rast të mirë për Arbërinë. Dritës i anulohet një gol për shkak të pozitës jashtë loje, por në minutat e fundit të pjesës së parë Festim Alidema e kalon skuadrën mysafire në epërsi (0-1). Në pjesën e dytë rastet munguan, por rezultati mbeti i pandryshuar. Pas kësaj xhiroje, Arbëria është në vendin e pestë me 11 pikë, kurse Drita është e dyta me 16 pikë.

Sot derbi Ballkani - Prishtina

Dy nga klubet favorite në garë për titull të kampionit në Superligë, Ballkani dhe Prishtina, do të përballen sot (e mërkurë) në Suharekë. Në fundjavë të dyja këto klube kanë pësuar humbje dhe synim i tyre është fitorja në këtë ndeshje mjaft të rëndësishme. Të përzgjedhurit e Ismet Munishit do të përpiqen ta përforcojnë pozitën e liderit në të cilën janë aktualisht, kurse kryeqytetasit do të përpiqen

që të mos lejojnë thellimin e diferencës. Ndeshje interesante do të zhvillohet edhe në Skenderaj ku Drenica kërkon fitore me trajnerin e ri, por synime të mëdha ka edhe Trepça '89, sidomos pas fitores ndaj Ballkanit. Gjilani pret ta marrë maksimumin e pikëve ndaj Besës, e cila këtë edicion po dëshmon se është e gatshme gjithmonë për befasi.

SUPERLIGA

Feronikeli - Llapi 1-0
Arbëria - Drita 0-1

Të mërkurën takohen:
14:00 Ballkani - Prishtina
14:00 Drenica - Trepça '89
14:00 Gjilani - Besa

Tabela

1. Ballkani	8	19 pikë
2. Drita	7	16
3. Gjilani	8	13
4. Prishtina	7	11
5. Arbëria	9	11
6. Trepça '89	8	11
7. Feronikeli	9	10
8. Drenica	8	8
9. Llapi	8	5
10. Besa	8	5

SHKURT

Mustafi paralajmëron largimin nga Arsenalit

Qendërmbrojtësi Shkodran Mustafi do të largohet nga skuadra e Arsenalit në fund të këtij edicioni, kur edhe i skadon kontrata. Mustafi ka refuzuar ofertën e Arsenalit për kontratën e re duke paralajmëruar klubin se do të largohet verën tjetër si futbollist i lirë. “Shkodran Mustafi dëshiron që karrierën ta vazhdojë diku tjetër. Ai së fundi ka refuzuar kontratën e re të klubit, duke paralajmëruar se do të largohet në fund të sezonit si lojtar i lirë”, ka shkruar “The Sun”.

Përforcohet KB Peja

Marko Peroviq është përforcimi më i ri i klubit të Superligës së Kosovës në basketboll, Peja. “28-vjeçari i gjatë 204 cm vjen nga Mali i Zi dhe luan në pozitën qendër. Në sezonin e kaluar ka luajtur në Ligën Superiore të Sllovakisë me një mesatare të mirë prej 13.4 pikëve dhe 4.1 kërcime”, thuhet në njoftimin e KB Peja.

Anulohet Kampionati Evropian U20, shtyhet sërish Evropiani U18

Federata Evropiane e Hendbollit të martën ka marrë vendime të reja për kampionatet kontinentale të grupmoshave të reja që ishin shtyrë për janar të vitit të ardhshëm. Vendimi ka ndikim edhe në kombëtaret e Kosovës. Kështu, Evropiani U20 i Divizionit B, në të cilin është dashur të paraqitet Kosova, është anuluar tërësisht. Evropiani U20 është dashur të mbahet në janar në Letoni. Fillimisht termini ishte për verën 2020, por më pas ishte shtyrë për në janar 2021 për shkak të situatës së krijuar me koronavirus. Tani EHF-ja e ka anuluar tërësisht këtë evropian, njëjtë si kampionatet e tjera të kësaj grupmoshe. Sa i takon grupmoshës U18, Evropiani i Divizionit B nuk është anuluar, por është shtyrë. Ngjarja e planifikuar të mbahet në janar 2021 në Mal të Zi është shtyrë për gusht të vitit të ardhshëm. Evropiani tani do të mbahet në Letoni, ndërsa do të marrë pjesë Kosova. Rrjedhimisht është anuluar edhe pjesëmarrja në turneun në Bullgari prej 12 deri më 15 nëntor. Për Kombëtaren U18 parashikohen aktivitete të tjera gjatë vitit të ardhshëm.

Plani i NBA-së për sezonin e ri

Komisionari i NBA-së, Adam Silver, pasi menaxhoi me sukses rikthimin në fushë të kampionatit pas pandemisë Covid-19, po mendon që tani për sezonin e ri 2020-2021. Për momentin nuk ka asnjë datë zyrtare se kur do të nisë kampionati, teksa synohet fundi i dhjetorit ose fillimi i janarit. Sipas mediave amerikane, objektivi i Adam Silver është data 22 dhjetor për t'i luajtur ndeshjet e para të sezonit të ri. Ky start i kampionatit në dhjetor bëhet për arsyen që ai të përfundojë para fillimit të Lojërave Olimpikë të Tokios. Në këtë mënyrë, yjet e NBA-së mund të shkojnë në Olimpiadë. Ky skenar parashikon një kampionat me 72 ndeshje në sezonin e rregullt, minimumi për t'u garantuar skuadrave kontrata televizive. Gjithashtu, duke qenë se “All Star Game 2021” është në dyshim për shkak të koronavirusit, mendohet që në shkurt ekipet të bëjnë një pushim 2-javor.

Ndeshje interesante në Superligën e Femrave

PRISHTINË, 27 TETOR - Në mesjavë do të zhvillohet java e parë në Superligën e femrave në basketboll, ku do të ketë disa ndeshje mjaft interesante. Ndeshja e parë e javës së parë për edicionin e ri do të zhvillohet në mes të Kastriotit

dhe Vëllaznimit, ku të dyja skuadrat kanë bërë disa përf forcime dhe shpresojnë ta nisnin edicionin e ri me fitore. Takimi më interesant do të zhvillohet ndërmjet Bashkimit dhe Penzës. Skuadra prizrenase të dielën fitoi

Superkupën dhe ka synime ta fitojë titullin, derisa Penza ka traditë dhe shpreson në një edicion sa më të suksesshëm. Sfida e fundit e kësaj xhiroje është në mes të Trepçës dhe Kosovahome Prishtinës. Skuadra prishtinase beson në

një edicion sa më pozitiv dhe sigurisht se, edhe ambiciet për trofe nuk mungojnë. Të mërkurën takohen: Kastrioti - Vëllaznimi (13:30), Bashkimi - Penza (18:00), kurse të enjten takohen: Trepça - Kosovahome Prishtina (16:30).



Juve kërkon hakmarrje ndaj Barçës për humbjen në finalen e Berlinit



"Epoka e re"

TORINO, 27 TETOR - Pa dyshim se ndeshja më e rëndësishme sonte (e mërkurë) në fazën e grupeve të Ligës së Kampionëve zhvillohet në Torino mes dy skuadrave finalistë të vitit 2015, Juventusit dhe Barcelonës. Koronavirusi do t'i pengojë tifozët që të jenë në stadium për ta parë përballjen në mes të Cristiano Ronaldos dhe Lionel Messit. "Zonjës së Vjetër" në këtë ndeshje i prin Andrea Pirlo, i cili e kishte zhvilluar lojën e fundit si lojtar i Juves pikërisht ndaj Barcelonës në finalen që triumfuese kishte dalë skuadra spanjolle. Ish-kampioni i botës debutoi si trajner në Ligën e Kampionëve dhe normalisht se kërkon ta bëjë me sukses. "Do të më pëlqente që të riluanim atë ndeshje të humbur, por e kaluara ka mbaruar. Barcelona ka shumë futbollistë të mëdhenj, pavarësisht prej mungesave, ndaj do të kemi shumë uri. Kjo na mungoi ndaj Veronës në pjesën e parë. Messi është pjesë e historisë së futbollit modern. Ai dhe Ronaldo kanë bërë gjëra të jashtëzakonshme në 15 vjetët e fundit. Jemi përballur me

të shumë herë, edhe pse moshën avancon për të gjithë. Të mërkurën do ta kem përballë për herë të parë si trajner, por do të kemi shumë respekt dhe shpresoj të mos jetë në mbrëmjen e tij më të mirë", ka deklaruar Andrea Pirlo, trajner i Juventusit.

Sytë e të gjithëve janë kah Ronaldo se a do të rezultojë negativ në testin për Covid-19 dhe në rast se

portugezi do të paraqitet, atëherë do të jetë përballja e parë me Messin që prej largimit nga Barcelona.

Giorgio Chiellini, Matthijs de Ligt dhe Alex Sandro janë mungesat e Juventusit, kurse Gerard Pique, Samuel Umtiti dhe Marc-Andre ter Stegen mungojnë te Barcelona. Në kuadër të Grupit G do të përballen edhe Ferencvaros - Dynamo Kyiv.

GRUPI E			GRUPI G		
18:55 Krasnodar - Chelsea 21:00 Sevilla - Rennes			21:00 Ferencvaros - Dynamo Kyiv 21:00 Juventus - Barcelona		
Tabela			Tabela		
1. Krasnodar	1	1 pikë	1. Barcelona	1	3 pikë
2. Rennes	1	1	2. Juventus	1	3
3. Sevilla	1	1	3. Dynamo Kyiv	1	0
4. Chelsea	1	1	4. Ferencvaros	1	0
GRUPI F			GRUPI H		
21:00 Borussia D. - Zenit 21:00 Club Brugge - Lazio			18:55 Istanbul B. - Paris Saint-Germain 21:00 Manchester U. - Leipzig		
Tabela			Tabela		
1. Lazio	1	3 pikë	1. Leipzig	1	3 pikë
2. Club Brugge	1	3	2. United	1	3
3. Zenit	1	0	3. PSG	1	0
4. Dortmund	1	0	4. Istanbul B.	1	0

SHKURT

Kumbulla: Nuk e mbulova Ibrahimoviçin si duhej

Marash Kumbulla e ka pranuar se i duhet të mësojë dhe të përmirësohet shumë, pasi ia siguroi një barazim dramatik Romës kundër Milanit të hënën mbrëmë. Përfaqësuesi i Kombëtares së Shqipërisë shënoi në fund të pjesës së dytë për t'ia nxjerrë Romës një pikë në barazim 3:3 me Milanin në "San Siro". Ky ishte goli i dytë për qendërmbrojtësin shqiptar në fanellën e Romës, të cilës iu bashkua këtë verë nga Hellas Verona. "Është mirë dhe e lehtë për ne të shënojmë nga ndërprerjet", ka thënë Kumbulla për "Sky Sport". "Unë mund të përmirësohem në këtë aspekt. E bëra një gabim te goli i parë që e morëm, të cilin kam mundur ta shmang. Por, isha me fat që u shpagova duke shënuar gol vetë", ka shtuar Kumbulla.

Mick Schumacher: Jam gati të garoj në Formula 1

Piloti i ri gjerman Mick Schumacher, aktualisht lider në botërorin e Formula 2, u shpreh se është gati për ta bërë hapin e madh, të kalojë në Formula 1 vitin tjetër. Ai është gati t'i ndjekë gjurmët e babait të vet Michael Schumacher. "Jam gati. Ndihem gati për të bërë hapin e madh. Nuk është një sekret që Formula 1 është ëndrra ime dhe e çdo piloti", ka thënë Schumacher, që garon me makinën Prema në Formula 2. Për pilotin gjerman, pjesë e Akademisë Ferrari, ka pasur mjaft kërkesa nga Formula 1, si Alfa Romeo apo Haas, makina që përdorin motorin Ferrari. "Nëse do të më krijohet mundësia për të garuar në Formula 1 që vitin e ardhshëm nuk do ta refuzoj ofertën", ka shtuar Schumacher.

Koronavirusi 'prek' Lazion, 8 lojtarë mungojnë në stërvitje

Tetë lojtarë kanë munguar të martën në stërvitjen e Lazios që, sipas mediave italiane, është tregues se virusi ngjitës Covid-19 është përhapur me të madhe në skuadrën e yllit të Kosovës, Vedat Muriqit. Të kaltrit stërvitjen të martën në mëngjes në mungesë të një numri të madh të futbollistëve të ekipit të parë, para takimit të së mërkurës kundër Club Brugge në Ligën e Kampionëve. Lojtarët që munguan ishin: Luis Alberto, Immobile, Andreas Pereira, Lucas Leiva, Manuel Lazzari, Danilo Cataldi, Luiz Felipe dhe portieri i Shqipërisë, Thomas Strakosha. Mediat italiane sugjerojnë se bëhet fjalë për një përhapje të madhe të Covid-19 në skuadrën e Lazios edhe pse kjo nuk është konfirmuar ende nga klubi. Raportohet se trajneri Simone Inzaghi e provoi këtë formacion në stërvitje: Reina; Patric, Hoedt, Acerbi; Marusiq, Akpa Akpro, Parolo, Milinković, Fares; Correa, Caicedo.

Hleb: Ende nuk e kuptoj pse e lashë Arsenalin për Barcelonën

Ish-ylli i Arsenalit, Alexander Hleb, ka thënë se ka gabuar kur e kishte lënë këtë klub për Barcelonën. Ai iu kishte bashkuar "Topçinjve" më 2005 nga Shtutgarti dhe pas tre vjetësh

kishte kaluar te katalunasit ku nuk kishte arritur të gjejë vend në formacionin bazë. "Tërë këto vite dhe unë ende mendoj për këtë gjë", ka thënë Hleb për podkestin "In Lockdown" të Arsenalit. "Nuk

e kuptoj. Edhe sot nuk e kuptoj se çfarë kishte ndodhur apo pse e pata marrë atë vendim. Sigurisht, Barcelona atëbotë ishte klubi më i mirë në botë, por unë vërtet isha i lumtur tek Arsenalit gjatë

asaj kohe. Kisha miq, më pëlqente trajneri, luaja për njërin prej ekipeve më të mira, fansat, stadiumi, gjithçka. Kampionati fantastik, Premierë Liga, gjithçka", ka thënë Hleb.



Ziraat Bank TC.ZIRAAT BANKASI A.S - DEGA NE KOSC**Bilanci i gjendjes me : 30.09.2020** Euro'000

	Tremujori paraprak	Tremujori vijues
Pasurite		
Paraja e gatshme dhe gjendja me BQ	7,187.10	7,687.99
Kërkesat ndaj bankave	711.28	683.36
Bonot e thesarit	-	-
Investimet në letra me vlerë	7,000.86	7,011.16
Kreditë dhe paradhëniet ndaj kliente	48,328.37	49,466.92
Patundshmëritë dhe pajisjet	1,232.57	1,147.75
Pasuritë e paprekshme	215.34	227.69
Pasuritë tatimore të shtyra	187.02	187.02
Pasuritë tjera	155.59	80.82
Gjithsej pasuritë	65,018.12	66,492.69
Detyrimet		
Depozitat e klientëve	43,899.14	43,391.67
Detyrimet ndaj bankave	6,186.88	9,212.55
Fondet tjera të huazuara	5,500.31	4,550.71
Detyrimet tatimore të shtyra	-	-
Detyrimet tjera	978.57	592.78
Gjithsej detyrimet	56,564.89	57,747.71
Ekuiteti i aksionarëve		
Kapitali aksionar	10,000.00	10,000.00
Rezervat e kapitalit		
Fitimi i mbajtur/(humbja) nga vitet p	2,177.05	2,177.05
Fitimi/(humbja) e vitit aktual	465.80	757.55
Përbërësit tjerë të ekuitetit	164.47	164.48
Gjithsej ekuiteti i aksiona	8,453.23	8,744.98
Gjithsej detyrimet dhe e	65,018.12	66,492.69

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Ministria e Infrastrukturës, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për ndërtimin e pjesës “E” të autoudhës Prishtinë-Merdare (OTEJL Korridor 7).

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 23.11.2020 në ora 10:00 në objektin e Komunës së Podujevës, do të organizohet debat publik nga Ministria e Infrastrukturës, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për ndërtimin e pjesës “E” të autoudhës Prishtinë-Merdare (OTEJL Korridor 7).

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us05web.zoom.us/j/86012608280?pwd=eGVackExYTVJa1gzNlU3MVl3U2J5Zz09>

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

Ziraat Bank TC.ZIRAAT BANKASI A.S - DEGA NE KOSOVE**Pasqyra e të ardhurave për tremujorin që përfundon me: 30.09.2020** Euro'000

	Tremujori paraprak	Tremujori vijues
Të hyrat nga interesi	1,558.78	2,441.10
Shpenzimet e interesit	506.23	789.36
Neto të hyrat nga interesi	1,052.55	1,651.74
Të hyrat nga tarifat dhe komisionet	368.06	492.43
Shpenzimet e tarifave dhe komisioneve	81.17	117.87
Neto të hyrat nga tarifat dhe komisionet	286.89	374.56
Neto të hyrat nga tregtimi	6.83	9.78
Neto të hyrat nga instrumentet tjera financiare	1.69	1.69
Neto të hyrat (shpenzimet) tjera operative	822.77	1,228.61
Gjithsej të hyrat	525.19	809.16
Provizionet për humbjet nga kreditë	56.81	52.76
Provizionet tjera	2.58	1.15
Fitimi/(humbja) para tatimit	465.80	757.55
Shpenzimet e tatimit në fitim	-	-
Fitimi/(humbja) neto	465.80	757.55
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	-	-
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse	465.80	757.55

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se “Arblini & Co” SH.P.K. ka marrë vendim të shuajë biznesin me NRB: 71221717, me nr. fis. 601549762 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Arblini & Co”, D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa bisnisom: 71221717, nr. fis. 601549762, ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the “Arblini & Co” L.L.C. has come to the decision to quit its business: 71221717, nr. fis. 601549762, the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

Lumë's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898
Sallon Depilimi Lumë's Details
lumessedetails
Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

facebook www.facebook.com/gjejpuneshpeite

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553
PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Anisa Shahini shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore SH.F.M.U. "Don Bosko" Prishtinë.
- Lirije Bahri Krasniqi shpall të pavlefshme certifikatën e shkollës së mesme "Lazgush Poradeci" Kijevë.
- Ardrit Pula shpall te pa vlefshme dëftesat e kl. X,XI,XII dhe diplomën e Gjmnazit "Hajdar Dushi" ne Gjakovë.
- Ymihane Hoxhaj shpall te pa vlefshme dëftesën e plot Sh.F.M.U. "Ali Hasi" ne Cërmjan KK Gjakovë. nga kl.I - IX.
- Ana Ramaj shpall te pa vlefshme dëftesat e kl. XI,XII te Gjmnazit "Hajdar Dushi" ne Gjakovë.
- Ali Gagjeri shpall te pa vlefshme diplomën e Sh.M.T. "Nexhmedin Nixha" ne Gjakovë.
- Zgjim Zogaj shpall të pavlefshme dëftesat, certifikatën dhe diplomën e SHMLT "11 Marsi" Prizren.
- Myvedete Kuqi shpall të pavlefshme dëftesat e klasës së I-VIII të shkollës fillore "Lekë Dukagjini" Prizren.
- Ganimete Gashi shpall të pavlefshme diplomën e SHMLT "11 Marsi" Prizren.
- Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.
- Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Feja", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Feja" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
- Lëshoj banesë me qira në lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.
- Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.
- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.



Bujar Salihu (1972) është nga Pogradja e Gjilanit. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në Gjilan. Në vitin 1990 filloi studimet në Fakultetin Elektroteknik të Universitetit të Prishtinës por, për shkak të rrethanave politike, u detyrua t'i braktisë ato dhe Kosovën. Që nga viti 1992 jeton në Zvicër. Ka botuar përmbledhjet poetike: *Në xipat e vetmisë* (1994), *Më pak se jetë* (1997), *Skeleti i dallëndyshes* (2002). Poezitë e tij janë përfshirë në disa antologji dhe janë përkthyer në disa gjuhë. Është fitues i disa çmimeve letrare. *Linga e heshtjes* është libri i tij i katërt.

26 vjet më parë, në moshën 22 vjeçe, një libër me poezi e botoi në dy gjuhë, në shqip dhe në frëngjisht. Pas botimit të librit të parë më 1994, i botoi edhe dy të tjerë dhe, me disa autorë shqiptarë, foli në disa gjuhë pasi disa përgatitës hartuan antologji me poezi shqipe. Veçantitë e tij letrare i kemi vënë re qëmoti, por edhe i kanë zënë ngoje Ali Podrimja, Shaip Beqiri, Mustafë Xhemaili, Arif Molliqi, Faik Shkodra, Xhemail Ahmeti, Nexhat Rexha e ndonjë tjetër që tash s'po na kujtohet. Prandaj, duke pasur veçanti më tepër se disa poetë të tjerë e duke qenë poezia e tij objekt krahasimi me atë të A. Tufës, L. Leshanakut, A. Balës, B. Cufajt, V. Berishës, R. Zekthit, I. Belliut, D. Gashit, M. Mavrajt, Xh. Beqirit, L. Arapit, Rr. Paçarizit, E. Hatibit etj., disa poezi të Bujar Salihut i kemi botuar në revistën *Akademia*. Me kalimin e viteve, ai duke shtuar veçantitë gjuhësore dhe tematike në poezi e ne duke veneruar krijimet e tij, këtë herë i botojmë këtë libër, i cili një shok tjetër e ka të rrallë. Lexojini të gjitha poezitë e këtij libri, por mos harroni t'i lexoni dy herë poezitë *Dita jote e fundit*, *Buka*, *Eja të pajtohem*, *Veshkat e vyshkura*, *Hija e qershisë*, *S'e mbajte premtimin*, *E përvojshme*, *Puthje*, *Mbrëmë*, *Në vend të pasthënies* dhe t'i mësoni përmendësh sepse fjalët, fjalitë, figurat, temat dhe motivet e tyre ju duhen shumë në jetën e përditshme.




Sh. B. Armagedoni

4⁹⁹ €

Linga e heshtjes

Bujar Salihu

Bujar Salihu



LINGA E HESHTJES
(poezi)



Arben Veselaj është gazetar dhe autor i disa librave letrare. Ka mbaruar studimet themelore dhe ato postdiplomike për letërsi në Universitetin e Prishtinës. Punon redaktor për kulturë në Radiotelevizionin e Kosovës. Në periodikët letrarë dhe shkencorë shqiptarë ka publikuar kryesisht kritikë dhe studime letrare. Disa nga tregimet dhe esetë e tij janë përfshirë në antologji të ndryshme. Në vitin 2001 botoi librin me poezi *Shpërrallosje*, kurse në vitin 2017 studimin *Tema*

kadareane. Më 2017, për zhanrin e kritikës dhe të eseistikës, u laureua nga Ministria e Kulturës e Republikës së Kosovës me Çmimin Vjetor për Letërsi.

Kur e kam lexuar dorëshkrimin *Triptikon arbëresh* të autorit Arben Veselaj më kanë ndodhur tri fenomene: 1. Disa herë më është dashur t'u kthehem disa faqeve përsëdyt, pasi më rrëmbente rrëfimi dhe shpesh nuk arrija të parashikoja asgjë - parashikimet më dilnin huq; 2. Jam kthyer në kohë dhe kam bashkëjetuar, para së gjithash, me De Radën e me Skiroin, pikërisht në sheshin e Shën Mitrit e të fshatrave të tjera arbëreshe të Kalabrisë e të Sicilisë; dhe 3. E kam lakmuar Arbenin që ka shkruar diçka që kam planifikuar së paku një tri vjet. Një krijim që arrin me i shkakti këto kokëçarje e kënaqësi, unë e përjetoj si kryevepër. E, ky libër ka histori, letërsi, politikë, peizazh... kulmi është shlyerja e kufijve zhanrorë që Arben Veselaj arrin ta bëjë.

Dr. Rrahman Paçarizi

Qasja askematike dhe johistoriciste mbi gjenezën e letërsisë shqipe dhe qytetërimin modern shqiptar, e bën këtë vepër unike dhe me rëndësi në studimet e albanologjisë. Libri *Triptikon arbëresh* i gazetarit dhe studiuesit Arben Veselaj është një adresë e re me vlerë të veçantë për studiuesit dhe hulumtuesit e rinj, mbi shumë të panjohura që qëndrojnë të stivuara e të pluhurosura faqeve të historisë së qytetërimit shqiptar. Rrëfyer nga sfondi i një ekspedite personale prej një gazetari e studiuesi të letërsisë, ky libër përbën sintezën e historisë letrare, politike dhe fetare të botës arbëreshe. Thellësia studimore, kombinuar me artin e të rrëfyerit, herë si shtjellim letrar e herë si reportazh, e bën atë shumë të dobishëm edhe për studentët e gazetarisë. Një apoteozë e madhështisë arbëreshe që na mban frymën gjatë të lexuarit.


Dr. Arben Fetosbi



4⁹⁹ €

Triptikon arbëresh

Arben Veselaj



ARBEN VESELAJ

TRIPTIKON ARBËRESH

(historikja, estetikja, ikonikja)

-  **S. GIORGIO ALB.**
Mbuzati
-  **VACCARIZZO ALB.**
Vakarici
-  **S. COSMO ALB.**
Strighari
-  **MACCHIA ALB.**
Maqi





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

